

QEMAL HAXHIHASANI

DOGANÇJA E FOLMJA SHOQNORE E ZEJTARVE SHETITËS TË RRETHIT TË PËRMETIT DHE LESKOVIKUT

I. Vështrim i përgjithshëm

Fjala *dogançe* përdoret si formim ndajfoljor: *rruc dogançe*, *ja pëlçet dogançe* (kupton, flet dogançe), po edhe si emën *dogançe* — *dogançja*. Me këtë termë kuptohet një nga të folmet tona shoqnore ma të përhapura nga pikpamja e shtrimit gjeografike dhe e zejtarve që e përdorin, si edhe ma të pasunat përsa u përket krijimeve të saj leksikore. Votra e lindjes dhe e zhvillimit të kësaj së folmeje asht Malshova, një krahinë malore që shtrihet në J.P. të Përmetit dhe që përmbledh, në një vështrim të zgjanuem, katundet Brezhdan, Limar, Malshovë, Leskaj, Kala. Prej këndeje ajo asht përhapë dhe flitet me variantet e veta nga zejtarë të tjerë shetitës: nga xharenjtë e Bualit, sharraxhitë e Rrëzës së Përmetit, mballomaxhitë e këpucarët e Podës së Leskovikut, muratorët e katundit Shalës, nga tavanaxhitë dhe kallajxhitë e Vërtoptit të Beratit. Elemente të shkëputuna të saj kanë arritë deri në rrethet e kallajxhive të Elbasanit, Kavajës, Tiranës e Shkodrës. Gjanësia e leksikut, stabiliteti i kuptimit të fjalëve, lehtësia e ndër-lidhjes morfologjike e sintaktike, i kanë dhanë aftësi kësaj së folmeje të shprehi, jo vetëm ide që kanë lidhje me nevojat e zanatit, po edhe mendime ma të ndërlikueme. Nga të folmet tona shoqnore, vetëm në *dogançe* ne kemi mundë të regjistrojmë biseda, ngjarje e tregime humoristike me karakter të gjanë tregimtar.

Përkrah fjalës *dogançe*, që përdoret ma shumë nga vetë malshovitët dhe që përban termën kryesore emërtuese të kësaj së folmeje, njihen edhe fjalët *malshovitçe* dhe *lovidharçe*. E para nga këto dy të fundit rron ma tepër në gojë të banorëve të krahinave që nuk e flasin këtë gjuhë: Këlcyrë, Dëshnicë, Dangëlli, etj., ndërsa fjala *lovidharçe* përdoret ekskluzivisht për të folmen e sharraxhive të Përmetit, e cila, sikurse do të shohim ma poshtë, ka mundë të bahet një variant i randësishëm i *dogançes*, një degëzim pothuejse i pavarun i saj.

Fjala *malshovitçe* lidhet me emnin e banorve të krahinës së Malshovës, të cilët mbahen si autorë të kësaj së folmeje (malshovit + mbrapashtesën prej burimit turk-çë; në analogji me zagoritçe, gjirokastritçe etj.). Termia tjetër *lovidharçe* ka në rranjë fjalën *lovidhe*, që do të thotë në këtë gjuhë *sharrë* (*lovidhar*: sharraxhi, *lovidharçe*: gjuha e sharraxhive). E koklaviun paraqitet prejardhja e termës *dogançe*. Vetë malshovitët nuk janë në gjendje të apin ndonji shpjegim bindës. Një arsimtar nga Limari e lidhte gët fjalë në mënyrë simpliste me emnin *doganë* "se kallajxhitë kalonin

nëpër dogana", dikush tjetër me fjalën tog, se malshovitët, kur dalin për punë jasht vendit të lindjes, shkojnë tog - grup.

Për shpjegimin e prejardhjes së kësaj terme Prof. E. Çabej, në punimin e tij *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, është shprehur kështu: "Kjo fjalë, e cila mungon te G. Meyeri, rrjedh prej bullg. *doganam* prej *ganam*. Sipas Y. Këngevit (Izvest. na Inst. za bulgar. Ezik IV, 1956) në ligjërimin e mjeshtrëve të Smolkos (Pirdopsko) në Bullgari *doganam* do të thotë "donasa, dokavan", dmth. "sjell, bie, vë në në dijeni". Prej verbit të bullgarishtes u formua, me anë të sufiksit turk -çe, adverbi *dogançe* (flas *dogançe*) e prej këndeje emri fem. *dogançe-ja*"¹⁾

Por në themel të kësaj fjale mund të jetë një emën topik mjaft i njohur në katundin Leskaj: *Togane-t²⁾*. Banorët e këtij katundi (dhe në këtë rast prioriteti në formimin e kësaj terme i takon Leskajt), tue u ndodhë larg vendlindjes, mund t'i kenë dhanë gjuhës së zanatit një emën të tillë, i cili u kujtonte në mënyrë simbolike dhe të pakuptueshme nga profanët, vendin e tyre. Por, ma tepër, ka mundësi që fjala *dogançe* të jetë me prejardhje turke, nga folja *dogmak*: me le³⁾ (*dolgan*: i lindjes). Edhe në këtë vështrim të fundit baza e formantit semantik asht vendi i lindjes (*ja pëlca-sim dogançe*: flasin në gjuhën e vendit të lindjes).

Ndonji dokument të shkruar për vjetërsinë e kësaj së folmeje nuk kemi. Simbas kujtimeve që ruhen nga tradita popullore, ajo mendohet të jetë përdorë të paktën që para rreth 150 vjetsh. Veç të dhanave për shpërnguljen e hanorve të parë të Vërtopit dhe të Malshovës së Beratit, të cilët duhet ta kenë sjellë *dogançen* që përdorin sot nga vendi i origjinës (Malshova e Përmetit⁴⁾, për këtë flasin edhe kujtimet, gojdhinat e anekdotat që tregohen rreth disa fetarve e zejtarve shetitës, që kanë jetue në këtë periudhë. *Dogançen* thohet se e ka përdorë me mjeshtri një farë Kiço Xhani, kallajxhi nga katundi Brezhdan, që ka vdekë para 100 vjetsh, Thanas Todhja nga Limari, i cili kish vu një pasuni të madhe tue ba lypësi si dervish malshovit me emnin Dervish Demiri, në krahinën e Dibrës, Tetovës, Gostivarit, Shkupit, Prizrenit, Malo Keci dhe Lame Maksuti nga Malshova, Sotir Xhorxhi e Emin Karafili, xerahë nga Buali, etj. Simbas të dhanave gje-nealogjike të barkut përkatës, të gjithë këta kanë jetue në gjysmën e parë të shekullit të kaluem, ndonjani ndoshta edhe nga fundi i shekullit të XVIII-të. Nuk ka gjithashtu të dhana për kohën, vendin dhe rrethanat, në të cilat u lidh dhe u përhap kjo gjuhë. Ne nuk dimë cilët qenë autorët e parë, nuk dimë se në ç'katund ose në ç'grup shoqnor nisi origjina e saj. Ata që kemi pyetë për sqarimine e këtyne çashtjeve na kanë dhanë pothuajse të njajtën përgjigje: "Kështu e kemi gjetur, kështu ka qenë folur den baba den!" Kjo ndoshta asht edhe një tjetër provë që hudh dritë mbi vjetërsinë e kësaj së folmeje. Faktet e afërme nuk i shpëtojnë kollaj identifikimit në traditën tonë popullore. Për ndonji të folme tjetër relativisht të re, siç ndodh p.sh. me dalipbeçen e belaxhive të Tomadhesë së Tiranës, mbahet mend jo vetëm koha, vendi dhe rrethanat e lindjes, po akoma edhe vetë autori i parë i saj.

1) E. Çabej Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe III, Buletin i Univers. Shtet. të Tiranës. Seria Sh. Sh. XV 1961, nr. 1 f. 66.

2) Me këtë emën njihet në Leskaj një vend i gjanë me ara (rreth 20 dynymë) dhe me një kishë të vjetër (kisha e Shëngjergjit). Banorët e këtij katundi janë sot muhamedanë. Kishës së Shëngjergjit, që hapet një herë në vit (më 6 maj) i ban shërbim fisi i Gjerkajt (nga katundi Zhej), i cili thohet se ka qenë shpërngulë nga Leskajt, kur u kthye ky katund muhamedan.

3) Sermed Muhtar Alus. Nouveau dictionnaire Turc - Français 2e edition, Istanbul 1935 f. 163; *dogmak* vn. Naitre /Se lever (astre).

4) Shih artikullin "Të folmet shoqnore, f. 99"

Emni *malshovitçe*, që i asht dhanë dogançes, siç u tha, nga profanët që s'e njohin, që nuk dinë ta flasin kët gjuhë, na ndihmon ta lokalizojmë burimin e saj në Malshovë. Njerëzve, që kanë krijuë një termë të tillë, sigurisht, u ka tërhekë vëmendjen përdorimi i kësaj së folmeje për herë të parë nga banorët e Malshovës, ose përdorimi i saj në masë prej banorve të kësaj krahine. Edhe gjanësia e leksikut, përhapja dhe shkalla e përdorimit sot flasin po për një fakt të tillë. Prandaj kërkimet tona u përqëndruen në një mënyrë të veçantë në njerëz të zejeve dhe moshave të ndryshme të katundeve të kësaj krahine Leskaj, Malshovë, Limar, Brezhdan. Prej këndeje ne i shtrimë kërkimet në Bual, një katund midis Malshovës dhe qytetit të Përmetit, banorët e të cilit kanë qenë të njoftun për ushtrimin e zejës së xherahut dhe të mjeksisë popullore në përgjithësi. Nji vemendje e veçantë u kushtue studimit të lovidharçes, së folmes së sharraxhive shetitës të Rrëzës së Përmetit. Për studimin e përhapjes gjeografike dhe të pikave të kontaktit me purishten u lanë kërkime në dy qendra të krahinës së Leskovikut, në Podë dhe Leskovik, si dhe në katundin Shalës që gjendet në skajin ma jugor të Kolonjës. Po për një qëllim të tillë, krahas me purishten, u mblodhën të dhana nga disa muratorë trebickallij dhe orgocallij që kishin lanë shumë kohë përpara vendet e origjinës së tyre dhe banojshin në rrethin e Përmetit. Në fund u lanë kërkime edhe në Vërtop të Beratit për qëllime krahasuese dhe për ndriçimin e disa çashtjeve të origjinës dhe të zhvillimit historik të dogançes.

Tipar karakteristik i kësaj së folmeje asht përdorimi i saj nga grupe zejtarësh shetitës — kallajxhi, xharej, sharraxhi, këpucarë, *muratorë etj.*; nga kjo pikpamje dogançja mund të renditet midis të folmeve profesionale (argots des métiers); por dogançja asht shfrytëzue edhe prej një kategorie njerzish, të cilët kanë jetue me ndihma që mblidhshin kinse për nevoja të institucioneve fetare (ndërtime teqesh, kishash etj.). Sado të maskueme në kët mënyrë, ndihmat e tyre nuk ishin tjetër, veçse një lloj lypje, dhe nga kjo pikpamje dogançja paraqit edhe një tipar tjetër karakteristik — ate të gjuhës së lypësve, të mashtruesëve, që asht i zakonshëm për disa të folme të tilla të popujve të Europës.

Të folmet shoqnore me qëllimin e tyre praktik — për të qenë një mjet komunikimi midis dy a ma shumë njerëzve që kanë interesa të përbashkëta, pa u marrë vesh nga të tjerët — lindin dhe zhvillohen kryesisht në terrenin e gjuhës amtare. Zejtarët që punojshin jashtë atdheut, nuk kishin nevojë të krijojshin një gjuhë të dytë, për të mos u kuptue në bisedat e tyre nga ambienti që i rrethonte. Gjuha amtare, e cila ishte e panjoftun midis këtyre popujve, shërbente mirë për kët qëllim. Kjo nevojë, përkundrazi, lindi në kushtet e ushtrimit të profesionit mbrenda vendit ose gjithazi në ato zona si p.sh. në Tebë të Greqisë, ku mbizotnonte elementi arbëresh dhe ku shqipja nuk ishte një gjuhë e pakuptueshme. Degëzimi i të folmeve të zanatit mbrenda terrenit të gjuhës amtare përlligj edhe ma tepër arsyen e emnimit të tyre si dialekte a të folme shoqnore të kësaj gjuhe.

Dinamika e të folmeve shoqnore, drejtimi i zhvillimit të leksikut, struktura dhe përdorimi praktik i tyre janë të lidhuna me ushtrimin e zejeve, me nevojat dhe interesat profesionale, me organizimin dhe mënyrën e jetesës së grupeve që i përdorin. Kallajxhitë p.sh. kanë përpunue ma tepër terminologjinë e enëve të kuzhinës dhe të procesit të meremetimit të tyre; xharejtë — terminologjinë e sëmundejeve, të barnave dhe mjekimeve popullore; sharraxhitë — ate të mjeteve të punës përkatëse, të veglave që u nevojiten për sharrimin dhe punimin e drunit; dervishët mal-

shovitë — terminologjinë fetare — të lutjeve, të ndjesave, uratëve etj. me të cilat sigurojshin ndihmat e besimtarëve. Njohja e rrethanave ku këto grupe ushtrojshin veprimtarinë e vet, e mënyrës së organizimit të jetesës jashtë vendlindjes, e kërkesave të tyne ekonomike e profesionale, ndihmon drejtpërdrejtë edhe në ndriçimin e problemeve që lidhen me specifikën e këtyne të folmeve, me formimin, strukturën dhe tiparet karakteristike të fondit leksikor të tyne. Prandaj, përpara se të futemi në shtruemjen e problemeve të analizës së leksikut, e shohim të nevojshme të apim disa shënime për organizimin, mënyrën e jetesës, kushtet në të cilat e ushtrojshin veprimtarinë e vet bartësit e këtyne të folmeve gjatë kurbetit të tyne stinor.

Rrethi i Përmetit asht në përgjithësi vend malor. Banorët e tij kanë qenë shtërngue prej kohësh të marrin rrugën e kurbetit, për sigurimin e jetesës. Ata kanë rrahë Stambollin, Bullgarinë, Misirin, ma vonë Francën, Amerikën Australinë. Kudo permetari ka qenë dallue për karakterin e tij të hedhun për inteligjencë, për aftësi praktike profesionale. Në kohën e perandorisë turke, çesmexhitë ma të njoftun të Vllahisë dhe Bullgarisë, bahçevanët, kasapët, sheqerxhitë ma të zot të Stambollit ishin përmetarë.

Banorët e këtij rrethi krijuen tradita mërgimi jo vetëm jashtë atdheut, po edhe mbrenda kufijve të tij, tue ushtrua këtu, simbas nevojave të vendit, zeje të ndryshme prej atyne që u përmendën. Malshovitët, banorët e krahinës së Malshovës, që mbahet si burimi i dogançes, janë marrë në kurbetin e tyne stinor mbrenda atdheut, me kallajxhillëkun. Kët zanat e kanë ushtrua pothuajse të gjithë ndenjësit e kësaj krahine — Malshova, Limari, Brezhdani (në kët të fundit numurohen rreth 70 shtëpi kallajxhish). Sot banorët e këtyne katundeve i gjen si mjeshtër të dalluem nëpër kooperativat e bakërpunuesve në Përmet, Berat, Kavajë, Durrës, Tiranë

Simbas të thanave të disa kallajxhive pleq të Brezhdanit, ky zanat ka ardhë për herë të parë në këto anë nga Stambolli. Ata përmendin edhe sot me nderim emnat e mjeshtërve të tyne të vjetër si Kiço Xhani, kallajxhi i njoftun para 100 vjetësh, Jorgaq Prillua, "i pari që e pruri kallajxhillëkun në Brezhdan", Vasil Gjikhëdhima, Vangjel Cimboku, Gaqe Gjikhmátua etj. Banorët e Limarit, përkundrazi, marrjen e këtij zanati e bien nga Greqia. Në fillim, thonë ata, kanë shkue si kallajxhi nga ana e Greqisë Zhe i Zagories; mbas zhiotve, me të cilët Limari ka lidhje krushqie, janë mësue të shkojnë nga ky krah edhe malshovitët. Si mjeshtër të dalluem prej këtyne katundeve përmenden Viktor Todhe, Stefan e Pilo Jonuzi, Sotir Kanollari, Mina Meshinaj, Lliko Gjikhëleka etj. Ka edhe ndonji tjetër që e nxirr prejardhjen e kallajxhillëkut në këto anë nga Përlepi i Maqedonisë.

Kallajxhitë delshin prej vendlindjes në bylykë, tue marrë me vehte veglat e punës-çekana, gërshanë, kudhra, zumba, kallaj, nishadër, pambuk, plumb, serë, ngandonjiherë edhe shtresat e fjetjes, kur kishin kafshë. Nji bylyk kishite zakonisht 3 vetë: nji që mblidhte enë, nji që i lante dhe nji që i kallaiste. Ky i fundit ishte "ustai"; ai që mblidhte enët ishte gjithashtu zanatçi i kualifikuem, se do të vlerësonte punën (sa para të merre për enë) dhe do t'u bante arnimin enëve; prandaj ustai i madh e quante kët"usta" si vehten, ndërsa i treti ishte "yzmeqari". Ky fërkonte enët me kambë e zhavorr. Ustai që kallaiste nuk luante nga shtëpia a vendi ku kishin qendrën e punës; ai që mblidhte enë bashkë me yzmeqarin delshin e kërkojshin punë nëpër katund. Kallajxhitë zakonisht kallaishin tepsia, tigana, kusi qumështi, kazana e çdo send tjetër që ishte prej bakri, bajshin meremete dhe zijshin me kallaj enët e shpueme. Ata që epshin enët për t'i kallaisë, epshin edhe drutë për zjarr. I zoti i enëve u çonte edhe ushqimin për sa kohë do të

punoheshin enët e tij (2-3 vakte). Pagesa bahesh në të holla — para çlirimit (1-10 lekë për bakër, ndonjiherë edhe në natyrë — me drith a bylmet). Të dy ustallarët i ndajshin përgjysëm paratë që merrshin. Hyzmeqari paguhesh me rrogë 1-2 dollarë në muej (fillestarët), të vjetrit paguheshin edhe ma tepër.

Kallajxhitë delshin nga vendi i tyne në mars, ndonji grup që bante marrëveshje ma parë, nisësh edhe në shkurt. Ata që do të vejshin në Veri shkojshin ma parë në Tiranë dhe prej këndeje shpërndaheshin, disa në Mat një pjesë nga Fushëkruja dhe kështu vazhdojshin nga Mati në Dibër, Lumë, Gorë, Tropojë ose në drejtimin tjetër Fushëkrujë, Milot, Zadrinë, Shkodër etj. Kur përndaheshin, nuk i tregojshin njani tjetrit se ku do të shkojshin. E kishin si rregull, kur ishte një grup kallajxhish në një katund, nuk futesh grup tjetër. Nisja e kurbetit të kallajxhivë lidhesh me përgatitjet që bajshin katundarët për punimin e qumështit. Në stinën e pranverës, me rifillimin e mjeljeve të bagëtive në stil të gjanë (nga dita e Shëngjergjit kur kputen qingjat), duhet të ishin gati edhe enët e ziemjes dhe të punimit të qumështit. Në fillim kallajxhitë mbrezhanakë, malshovite etj. kanë pasë punue në krahinat e Jugut: Skrapar; Kolonjë, Opar, Berat, Myzeqe; ma vonë, thohet se me rekomandimet e sheqerxhivë të Kukësit (që punojshin në Jugë), në kohët e fundit, edhe të ndonji ushtaraku verior që bajshin mik në Toskëri, u hodhën edhe përtej Shkumbinit, në krahinat veriore.

Në krahinat e afërta (në Jugë) nuk qëndrojshin për shumë kohë. Përkundrazi rrihshin 2-3 muej dhe ktheheshin në shtëpi simbas nevojave bujqësore që të kishin. Kështu shkojshin në mars-maj; ktheheshin për të korrë grunin në shtëpi në qershor e korrik; në gusht shkojshin në Dëshnicë; Dangëlli e Skrapar, se ishte vala e bereqetit atëhere atje; në nandor, dhetoj; janar kalojshin në Breg të detit (Himarë etj.) dhe në Mallakastër, se ishte koha e ullinit, e vojtit. Kallajxhitë kishin edhe preferenca të ndryshme simbas kushteve të punës dhe të jetesës. Mallakastër i kishte enët të vjetra; dojshin shumë punë për t'u rregullue, kurse Himara ma të mira dhe voji ishte ma i bollshëm, prandaj rrihshin ma tepër në këtë krahinë të fundit. Puna ma e parë që bajshin kallajxhitë, kur futeshin në një katund të pa-njoftun, ishte caktimi i konakut të fjetjes dhe të punës. Kishte raste kur këte e zijshin me pagesë, po kishte edhe raste kur i zoti i shtëpisë i mbants për miqësi ose me një pagesë simbolike (tue i kallaisë nga një enë bakri në shtëpi). Deri sa të fillojshin nga puna kujdesohesh i zoti i konakut për ushqimin e tyne, pastaj buka u vinte, sikurse u tha, nga ata që sillshin enët për kallaisje. Flijshin zakonisht në plaçka e tyne, por ngandonjiherë delshin edhe pa plaçka dhe flijshin ku t'i zinte nata, keq e tukeq. Pastrimin e rrobave e bajshin në katund. Kallajxhitë ua shpërblejshin me punë (kallaisje e meremetim bakrash).

Krahinat ku kalojshin ma mirë kallajxhitë ishin Myzeqeja dhe Dibra. Në të parën ishte zakon t'i baheshin kallaisjet gjithsekujt në shtëpinë e vet. Edhe ushqimi e fjetja u siguroheshin kallajxhivë po aty (së bashku me njerzit e shtëpisë). Në Dibër ata mbaheshin gjithashtu shpeshherë me ngranie e me fjetje nga miqtë. Veç kësaj atyne u siguroheshin këtu edhe disa të drejta simbas kanunit të vendit, lidhun me pagesën e punës, të qarkullimit nga një katund në tjetrin me "ndore a besë" etj. "Ay që na lëshonte konakun në Dibër, i zoti i shtëpisë ku punonim, tregon Vasil Daçua, një kallajxhi i motçëm prej Brezhdani, që kish ba rreth 15 vjet kurbetllek nga Veriu, "kishte përgjegjësi për llogaritë tona, që të mos na ndodhte ndonjë ngatrrësë në çeshtjen e pagesës etj." Edhe fshatarët e pranonin dhe e respektonin vendimin që epte ay në të tilla mosmarrëveshje ndërmjet kallajxhinjve

dhe fshatarve që shpinin bakrat për t'i kallaisur. Kudo që të ngulnin kallanxhinjtë në një fshat, qofshin në shtëpia me influencë, qofshin në më të humburin e fshatit, fshati ish i detyruar ta njihje dhe ta respektonte atë si kryetar të kallanxhinjve dhe t'i bindesh çdo vendimi që të epte ay. Respektoneshin edhe zakonet e vendit. "Ne na ka ndodhur shpeshherë të lëviznim nga një fshat në tjetrin në "besë" të ndonjerit."

Kallajxhive u takonte zakonisht t'i festojshin pashkët në kurbet. Atëhere ata mbledheshin 2 a 3 grupe dhe i bajshin pashkët së bashku. Ky ishte pothuajse i vetmi argëtim i jetës së tyre intime në kurbet. Qëndresa nëpër katunde varesh nga puna që u delte. Kishte raste që rrijsin rreth dhetë ditë në një katund dhe atëhere ishin të detyruem ta fillojshin punën në mëngjez herët dhe ta lijsin kur erresh dita; po kishte edhe raste që lëvizëshin prej një katundi në tjetrin mbrenda ditës. Ngandongjherë ishin kaq të nevojshëm për punë sa mund të shkarkojshin plaçkat edhe për një shtëpi të vetme (për 2—3 orë punë). Paret ua dërgojshin familjeve herë pas here nga qendrat e krahinave ku punojshin: Peshkopia, Kukësi, Shkodra etj. Nji e shkucme në kurbet u zinte, në kohë të Zogut, rreth 300-500 fr. për grup. "Po të sosim në shtëpi 200 fr. për shoq, veç shpenzimeve, ishim të lumtur" më thonte një kallajxi brezhdanak. Ky lloj kurbeti ishte stinor — zgjaste nga pranvera deri në vjeshtë. Nji pjesë e kallajxhive këtheheshin në vendlindjet për shëmitër (26 tetor), nji pjesë për shëmërtir (14 nandor) dhe nji pjesë kërshënellave (25 dhctor).

Bylykët që vejshin për punë në Greqi niseshin në vjeshtë. Udhëtojsin me vapor deri në Pirë; prej këndeje kalojsin në Athinë dhe nga Athina shkojsin në "Thivë" (Tebë), fshatrat e së cilës, me ndonjë përjashtim të rrallë, janë barbaçë. Kurbeti në Greqi zgjaste zakonisht 2-3 vjet. Gjatë nji periudhe të tillë kallajxhitë tanë kishte raste të futeshin në jetën intime të barbaçëve dhe të ngjallshin në ndërgjegjen e tyre kujtime të përmallëshme për mëmëdheun e largët. "Sa na dëgjonin të flisnim shqip — tregojshin kallajxhitë që kishin punue në ato anë — na thonin: "U, arbër qënke ti? Edhe ti ditke arbërishte!" Pastaj i flisnin njeri tjetrit: "Janë nga Qyshëria, janë arbër". Tue bashkëjetue me barbaçët kallajxhitë tanë kishin mësue zakone dhe kangë popullore të tyre, fjalë shprehje, urime etj. (dej, kosdej, çon, qalle, salle, eja torrë, jam e ngalkuame, të rruat kriet, e dielt etj.). Meqënëse barbaçët e kuptojshin shqipen, kallajxhitë shqiptarë shtrengeheshin të përdorëshin doganën për t'u marrë vesht midis tyre. Paratë në familje i dërgojshin sipas nevojave dhe fitimeve që kishin, por ma tepër në krye të çdo vjeti (kur i vente mirë puna rreth 30 napolona në vit). Bylykët largoheshin nga Greqia zakonisht para kërshnellave. Rrobet e fjetjes dhe mjetet e punës i lijsin atje ndër miq. Bylyku i Limarit i linte, në kohët e fundit, në katundin Kriekuq te nji farë Thanas Qyshi.

Kallajxhitë, ashtu si edhe zanatçijtë e tjerë shetitës, kanë pasë jetue të ndrydhun dhe të mënjanuem nga jeta sociale e vendit. Karakteri i përkohshëm i punës, vështirësitë ekonomike, kushtet e randa të jetesës dhe të ushtrimit të zanatit jasht vendlindjes, brumosshin te ata nji psikozë dyshimi dhe pasigurie të përherëshme. "Ne e ndjenim velten të huaj jo vetëm në Greqi, po edhe në vendin tonë" më thonte nji kallajxi i vjetër nga Malshova. Ata hasshin vështirësi dhe pengesa gjithfarësh në sigurimin e punës, të vendqëndrimit, të ushqimit, në kapërximin e rreziqeve që u kërcoheshin gjatë lëvizjes prej nji katundi në tjetrin në kushtet politike të periudhës së pushtetit turk, kur jeta e njeriut ishte e pasigurtë nga mungesa e autoritetit zyrtar. Në këto rrethana përdorimi i nji gjuhe të veçantë, të pakuftueshme nga ambienti, midis pjestarve të grupit për

kapërximin e këtyne vështirësive, delte si nevojë e domosdoshme jetësore. Mbi kët bazë materiale lindi dhe u zhvillue edhe e folmja e kallajxhive, dogançja. Rastet e përdorimit të saj në kurbet ishin pothuajse të rregullta. Ustai u epte ndihmësve porosinë në dogançe që kur futeshin në një katund. Dogançe u fliste ai edhe kur u epte ndonji udhëzim lidhur me punën. Në dogançe bisedonin ndihmësit kur këshilloheshin njani me tjetrin për vlerësimin e punës që kishin ba dhe caktimin e çmimit.

Objekt bisedimesh në dogançe bahesh sidomos çashtja e ushqimit, e fjetjes, e kujdesit për të sigurue hesën dhe mirëmbajtjen e kafshëve. Këto, sikurse u tha ma sipër, siguroheshin nga punëdhanësit. Por, në shumë raste, duhesh ndërhyrja e të interesuemve, për të pasë p.sh. një gjellë të mirë, për mirëmbajtjen e kafshëve etj. Në kësi rrethanash ishin të zakonëshme biseda të tilla: Ustai: *U pykosëm nga vardja. E mërxejmë tashti* (U këputëm nga puna. E lëmë tashti). *Fryni të çivriseni me shkumbës* (Shkoni të lahëni me sapun). *Ti fryj e na qëro gjonthin* (Ti shko e na merr bukën). A. *Rokanisi të na ftoi të kolme gjanthin; rokanisi dhe për nonjë manxhë të kolme. Aniksi trocet, po të ftoi nonjë manxhë të thantë, mërxe* (Foli të na e api të mirë bukën; foli edhe për ndonji gjellë të mirë. Hapi sytë, po të api ndonji gjellë të keqe, lenë). Ustai: *S'është vardje kjo! Mërxei rokanet, se citisim si arot* (S'asht punë kjo. Lini fjalët se bahem si arixhitë). *Neve ja pëlcamim tekëthaxhinj, ç'të na ftojnë, do ta qërojmë* (Ne jemi zanatçi, ç'të na apin, do ta pranohjmë). A. *Na ftoi manxhë të kolme: gjonth zisto, të leshtë, balo, çoculla edhe një shapkar të kolme* (Na dha gjellë të mirë: bukë të ngrohtë të ngryjtë, mish, fasule, djathë edhe një byrek të mirë). *Ky tjetri s'ja pëlçiste, na ftoi mbytë. Edhe gjonthi ja pëlçiste mbojths. M'erdhi çfuqe, pa do ta petaksja kaio* (Ky tjetri s'kishte, na dha gjizë. Edhe buka ishte e misërt. M'erdhi turp, pa do tja hudhja për tokë)). Ustai: *Kol ke citisur* (Mirë ke ba). *Fry e na qëro nonjë çotë me kucëre ose me vardje* (Shko e na merr ndonji pulë me para ose me punë). *Avrio ja pëlcamim kukule. Do të dredhim kol: balo, pembojka, mbleko, kulo, shapkar* (Nesër kemi pashkë. Do të hamë mirë: mish, vezë, qumësht, kulaçe, byrek). *Mëngresi ja pëlçet rrethje sonte. Legosni të dredhni, po mos sherosni thanuqe, se ju çapon e s'citis të qezriten kemsit me ne* (I zoti i shtëpisë sonte ka dasëm. Slëkoni të hani, po mos pini raki se ju z dhe nuk ban të tallen vendësit me ne). *Fryni e dufritni okso* (Shkoni e flini jashtë). *Zogosni edhe korto për kapuq* (Kërkoni edhe bar për gomarin). A. *Firose firjen, se ja pëlcam i zaganjepsur* (Mbylle derën se jam i sëmundë). *Më ka qapuar një loshe që po m'pikos* (Më ka zënë një kollë që po m'merr shpirtin). *Kam dufritur okso në një palesht. Citisa edhe një forfol, po nuk ja pëlçisnja veç një gano të shidhërt për t'u kuspulluar. Nuk më ka qapuar dufri fare. Rrucova konjëza tërë xhërrën* (Kam flejtë përjashta në një shpellë. Bana edhe një zjarr, po nuk kishje veçse një gunë të vjetër për t'u mbështjellë. Nuk më ka zanë gjumi fare. Preva gozhdë gjithë natën).

Dogançja përdoreh sisomos për kapërximin e rreziqeve, që shpeshherë u kërcënohshin edhe jetën zanatçive shtetës. Njerëz të dyshimtë gjurmohshin fitimet e tyre, ruejshin rastet kur ishin ata të pambrojtun dhe u delshin përpara për t'u marrë të hollat. "Më ka ndodhur mua në Krasniqe, tregon Solir Dacua, në mbarim të punës na bënë llogarinë se sa kishim fituar në tërë fshatin. Shoqëruesi që kishim marrë me vehte nga frika, kur vajtëm një copë rrugë, nisi të fërshellejë. I them ndihmësit në dogançe: *Nuk e legos kol kët mëngresin, kam xeno se do të na citis nonjë vardje, po të frymë prapë në garth* (Nuk e shoh mirë këtë shoqguesin, kam frikë se do të na bajë ndonji punë, po hajde të kthehemi prap në katund). U dhamë këmbëve për në fshat. Po të mos kishim takuar me disa udhëtarë, qenë

duke na xhveshur shoqëruesi me shokët e tij, që po na ndiqnin pas. "Një natë na u futën në konak dy lumjanë, tregon një tjetër kallajxhi malshovit, unë e kuptova se ç'qëllime kishin dhe i thashë ndihmësit në dogançe: *Citis si të citisish dhe rokanisi të bëjshmit të gardhit se na kanë ngreuar dy niko* (Ban si të bash dhe thuej kryeplakut se na kanë ardhë dy hajdutë). Vjen kryeplaku dhe me të vërtetë ata kishin qenë nga një fshat tjetër. Kishin ardhur të na merrnin paratë." Ngjarje të tilla tregojnë edhe për periudhën turke. Në katundin Podë të Leskovikut kishin ardhë disa xhandarë turq për të zanë një farë Petro Ngjelo. Xhandarët takohen rastësisht me vetë Petron (pa e njohur se kush ishte Petro Ngjelua) dhe i thonë t'i çojë të kryeplaku, Josif Markua. Shkojnë atje dhe i tregojnë xhandarët kartat Josifit, kartat që kërkojshin Petro Ngjelon. Josifi i drejtohet Petros në dogançe: *Camosu, o cimadh se ta thurën tortëzest* (Mshihu, o djalë, se të kapën xhandarët), pastaj i flet shqip: *Shko tani e na sill Petro Ngjelon*. Iku ky e u zhduk. Pritën sa pritën këta dhe shkuen vetë në shtëpi të tij. Njerzit e shtëpisë i thonë se "Petrua ka kohë që s'gjendet aty, ka vajtur për punë nga Devolli."

Faktor i randësishëm për lavrimin e dogançes dhe për pasunimin e fondit leksikor të saj, kanë qenë edhe dervishët malshovitë. Krahina e Malshovës nga pikpamja fetare, asht e përzieme: Kalaja e Brezhdani janë thjesht të krishtenë, Malshova e Limari — të përzieme (shumica të krishtenë, një pjesë muhamedanë), Leskajt krejt muhamedanë. Kthimi në fenë islamike duhet të jetë një fenomen jo fort i hershëm. Në katundin Leskaj gjenden akoma në kambë dy kisha. Sidoqoftë islamizimi i banorëve të këtushëm duhet të ketë ndodhë para kohës së Ali Pashës. Leskajt i përkasin sektit halveti. Në këtë katund ka edhe një teqe të këtij secti, teqja e Haxhibabajt, themeluesi i së cilës duhet të ketë qenë një nga misionarët e përhapjes së islamizmit në këto anë. Teqja e Leskajt ka qenë mbajtë si një vend i shejtë dhe i nderuem.

Banorët e katundit Leskaj, ma vonë edhe ata të Malshovës e të Limarit, në shëmbëllim të shehlerve të kësaj teqje, visheshin me *harka* të zezë, vejshin në krye qylafin e rrethuem me shall të zi, varshin një *teberr* (një si sëpatë — simbol të tarikatit), përgatitshin te zilexhitë *mëshyrin* Sulejman me pesë cepa e me shkrime arabisht për të vulosë nuskat dhe delshin katundeve për *lipësi*. Nga vendlindja largoheshin në grup, 8-10 veta, pastaj përndaheshin dy nga dy nëpër krahina të ndryshme — në Myzeqe, në rrethet e Kavajës, të Elbasanit, të Dibrës, Tetovës, Shkupit, Prizrenit, Prishtinës, etj. (në krahinat ma të lidhuna me traditat fetare). Njani hiqesh si *mërshiti* (si baba, sheh i madh), tjetri si dervish (hysmetçiu i tij). Shkojshin tur trokitë nëpër porta dhe hyjshin në bisedim kryesisht me gratë: *Hejvall nazari! Ka ardhur kalanderi! Ju është prishur nakafaja, s'ju rrojnë fëmija s'ju bëet bereqeti, ju kanë marrë në gazep njerzit e hyqynzëtit, t'ju bëjë babai një nuskë, që t'ju këthenet mbarësia!* Kështu u shkruheshin nuska për t'u ba bereqeti, për shtimin e bagëtisë, për lindje, për sëmundje të ndryshme për kokë, zemër, sëmundje epidemike etj. Katundarët u epshin para ose bereqet. Këto merreshin si ndihma për mirëmbajtjen a për nevoja, kine të teqeve a të xhamive të njoftuna. Kur pyeteshin nga populli *Ku bën hysmet ti baba*, ju përgjigjeshin për vakëfet ma me influencë, p.sh. në *Teqenë e Tomorrit*, në *Ballëmsulltan* (Elbasan), në *Teqenë e Kurrillës* (Prizren) etj. Kur nuk i pranojshin nëpër shtëpina, flijshin në teqe, xhamina, kisha. Nuk kishin ndruejtje nga *shejtënia* e tyne. Përkundrazi, vejshin dorë shpeshherë edhe në ndihmat e dhana për to. Një dervish nga Leskaj më tregonte se nuk kishin lanë dru e dhurata të tjera që u faleshin vakëfeve pa djegë e pa marrë.

Në krye të javës e qitshin bereqetin e mbledhun për ta shitë në pazarin ma të afërm (*Na këtë bereqet e shpjere në pazar se është bereqeti i teqesë*).

Në fund të afatit të caktuem, bashkoheshin në një qendër i tanë grupi dhe ndajshin fitimet. Kishin një farë esnafnie midis tyre. U hiqshin pjesën përkatëse edhe atyne që sëmuheshin.

Për daljen dhe kthimin nga ky lloj kurbeti nuk kishte ditë të shënueme. Zakonisht qëndroshin 5-6 muej, në stinën e verës dhe të vjeshtës.

Bolleku i t'ardhunave dhe lehtësia me të cilën grumbulloheshin fitimet nga një maskim i tillë, i kishte tërheqë vemendjen edhe elementit ortodoks. Të krishtenë nga Maleshova dhe Limari, në shembullin e bashkëkatundarëve muhamedanë, visheshin si dervishë dhe bajshin të njajtën punë nëpër krahinat myslimane. Për një farë Thanas Todhja nga Limari që duhet të ketë jetue në gjysmën e parë të shekullit të kaluem, thohet se kishte vu një pasuni të mirë me këte lloj zanati. Thanasi, i shndrruem me emnin Dervish Demiri shkente "për lipësi" sikurse asht përmendë ma sipër, deri nga Dibra, Tetova, Gostivari, Shkupi, Prizreni dhe sillte me qindra napolonë nga çdo udhëtim. Një tjetër i krishtenë nga Malshova — Kristofor, kish lanë nam si dervish me emnin Malo Keci. Malos i kish takue të varroste edhe njerëz në vendet ku shkente për lipësi. Në një varrim të tillë djalin, që mbante mbrapa (edhe ky i krishtenë, i veshun si dervish), e kish vu në majë të arrës për të pa se mos vinte ndonjë hoxhë dhe i nxirrte në shesh mashtrimin që i bante popullit. Malua, kinse po këndonte të vdekunin, i drejtohej me za të naltë ndihmësit të tij: *O cimadh, legos kol nga fryn leka se mos ngreson kokëpëshjtjelli. Ty ta thur e s'ta thur, po mua ma thur e ma liron* (O djalë shih mirë nga perëndon dielli, se mos vjen hoxha. Ty të ban e s'të ban gja, po mue më fik fare). Katundarët nuk kuptojshin se ç'lo-dër luhesh, po veç thirrshin, *amin, amin!* Në një katund tjetër kishte shkue të varrosi një tjetër njeri. *Ç'ja thonë emrin, e pyet Malua kallaballëkun. Selim i thanë ata. Edhe ky aty për aty: O Selim, o burr' o trim / kallk anasën sitin* (vargu i fundit sharje e randë në turqisht). Populli nuk kuptonte gja, veç pëshpëriste: *Amin,amin!* Malua ka lanë edhe anekdota të tjera, me të cilat shihet zgjuetsia dhe guximi i tij për të kapërxye rrethana të tilla të vështira.

Në një vijë të kundërt ka ndodhë që të baheshin edhe muhamedanët priftën në zonat e krishtene. Visheshin në këto raste me kamillafë, mbajshin çarçafë me kryqa mbrapa, merrshin ikona shejtorësh, mjete për shërbesat fetare: kusi, borzilok, kryqa, themjanica; paraqitshin ndonji si autorizim nga igumeni i Manastirit, të shkruem me një shkrim gati të palexueshëm në greqisht; mbajshin shënim nëpër lista emnat e atyne që ndihmojshin për t'u përmendë gjoja emni në meshë. Nji farë Demkë Malja, nga Leskajt, kish veshë 12 vetë si priftën dhe i ish lëshue Myzeqesë (në kohë të pushtimit turk): *Jemi kallogjerët e Shën Naumit t'Ohrit*, thoshin, *shuajm zjarr' e kolerës*. Këta psallshin edhe nëpër kisha. Nuk dishin gjana të mëdha, po kishin mësue ndonji fragment përmendësh dhe kët e paraqitshin me kaq seriozitet sa dukesh tamam si këndesë fetare. Pleq të këtyne anëve tregojnë edhe sot fragmente të tilla me të cilat mashtrojshin popullin dikur:

5) Në folklorin , mbledhun në Molshovë ka një kangë popullore dasme. që i qe ngritur së bijës së Viktor Todhës (Dervish Demirit), kur u martue në katund. Ajo dëshmon qartë si për pasuninë që kish vu Viktori ashtu edhe për adoptimin e emnit Dervish Demiri, prej tij:

Nuse e bia të mirit,
e bia Dervish Demirit!
Nuse të punoi bafti,

e more burrën nga fshati,
more të bir' e peshajt,
të nimn e Vito Karajt!

Të tre yjt e mëdhej
të yjnisë të së djelshmes,
që ndriçuan botën e tërë,
Vasilin e math,
Kristo Geoguthullin . . .

Priftënit shkojshin gjithashtu dy nga dy. Ai që mbahesh si prifti i parë, kur bante sikur psallte në kishë, bisedonte me ndihmësin e tij: *Lidhosi, krisjau se ky ja pëlçet krankua i bëshëm, ky ja pëlçet drangullat e shejta, krisjau se ky ja pëlçet rrutës i bëshëm, citiz hyzmet në shën Spiridon të Korfuzit* (Gënjei, thueju se ky asht prifti i madh, ky i ka qitapët e shejta, thueju se ky asht prift me randësi, ban hyzmet në Shën Spiridon të Korfuzit).

Dervishët e priftnit malshovitë talleshin me njerzit që mashtrojshin. U thoshin: *Jemi dervishët e teqesë së Zastenit! Na epni se do ngrejmë teqenë e zZastenit — Jemi kallogjerët e Petranikut! Jemi kallogjerët e Hingës! Epni ndima për Manastirnë e Petranikut! Hë zoti u ndihmostë!* Të gjitha këto — *Zasteni, Hinga, Petraniku*, ishin toponime të Limarit e të Malshovës, shkambij e përroj që mbaheshin nga malshovitët si vende të rrezikëshme, ku rri-shin hije, djaj, shpirtra të këqij. E bajshin pra vehten si djaj. Kur u epshin ndihma, u thojsin grave: *Hëni bijat e babajt, u rrofshin djemtë, u qëroftë zoti cimëdhejtë!* Fjala e fundit u shpjegohesh se donte, gjoja, të thonte *djajtë*, shpirtnat e këqij, por në dogançe do të thonte *fëmitë*. *Ju ja pëlçisni toro!* *Jua çkërthça në rrabë!* (Ju jeni budallaqe, ju shofsha kokën). Gratë: *Ymër baba! Ymër baba dervish!*

Që të mund të kishin sa ma shumë sukses në këto ndërmarrje mashtruese të tyne, dervishëve u duhesh të bajshin një punë të kujdesëshme paraprake. Pyetshin ma parë njerës të ndryshëm — gra, burra, fëmijë për gjendjen e familjeve që kishin interesat të shfrytëzoshin. Kështu merrshin vesh p.sh. se në kët ose në atë familje kishin ndodhë këto ose ato fatkeqësi (vdekje, sëmundje të randa, grindje midis vllaznish, damtim në bagëti, etj.). Këto, pastaj shtireshin sikur i zbulojshin nga librat e shejta. Hapte librin e shejtë dhe i thonte një grueje p.sh. *ty s'të ka dhënë zoti fëmi. E thotë qitapi, bija e babajt! Juve u ka hyrë grindja, ju ka lidhur bota me magji. T'ju bëj babai një nuskë, një duva, të shpëtoni nga taksirati!* Për një dervish që bante lypësi në rrethin e Kolonjës thohet se varrosi gomarin (që i kish ngordhur rrugës) dhe vu kujën sikur gjoja i kish vdekë *mërshiti* (kryebabaj). Katundarët e ndihmuen për t'i ngritë një tyrbe, e cila u quejtë tyrbja e *Kullakbabajt* (baba veshgjatit). Malshoviti e ktheu varrin e gomarit në një vend të shenjtë dhe e bani burim jetese.

Këto veprime mashtruese bijshin shpeshherë në kundërshtim me qëndrimin realist të njerëzve. Në disa katunde dervishët malshovitë nuk i qasshin mbrenda fare. Kishte raste kur ata demaskoheshin haptazi si të dyshimtë, gënjeshtarë e mashtrues.

Përdorimi i një gjuhe të pakuptueshme nga ambienti, midis këtyne njerëzve, ishte i domosdoshëm. Jo vetëm nevoja për kapërximin e vështirësive, po e gjithë veprimtaria e tyne — kurthet që ngrejshin për mashtrimin e një rëzve, përpjekjet për shfrytëzimin që u delshin përpara, etj. — mbështetëshin mbi trillime, marrëveshtje e komunikime të mshehta që bajshin ata me njanitjetrin. Përdorimi i dogançes nga kjo kategori njerzish përmban të vetmin rast që u ep të folmeve tona shoqërore një përdorim për qëllime negative. Nëqoftëse të folmet e tjera përdoren lidhun me ushtrimin e zejeve dhe me mbrojtjen sociale të ushtruesve të tyne, te pseudofetarët malshovitë këto të folme futen në punë kryesisht për qëllime mashtruese.

Dogançen, veç kallajxhive dhe dervishëve malshovitë, e kanë folë edhe banorët e katundit Bual të Përmetit. Buali sot asht një katund i vogël me rreth 30 familje (22 të krishtena dhe 8 muhamedane), por, para çlirimit numëronte deri 130 shtëpi. Shumica e tyre mbaheshin të ardhun nga një katund i prishun, pak përtej Bualit të sotshëm, që quhesh Cfrat; ndërsa për një pjesë thohet se ishin me origjinë nga Malshova. Ashtu si përmetarët e tjerë, edhe bualiotët kanë pasë rrahë kurbetin — ma tepër Stambollin dhe Greqinë. Atje punojshin si kasapë, bahçevanë, sheqerxhi. Por mjeshtëria kryesore e tyre mbrenda vendit dhe në disa provinca të tjera të ish perandorisë otomane, ka qenë mjekësia popullore. Banorët e Bualit kanë qenë njoftun në krejt Shqipërinë, në Maqedoni, Greqi e gjetiu si *unuri* a si *xharenj* (*xherahë*). Ata shërojin frangjyzën, koqurinat (bulzat), helmimet nga gjarpni, nga bakri, plagë të ndryshme, qeroskën, zgjeben, sëmundjen e moros (një kokë që lëshonte rranjë, delte që nga xverku e nalt); bajshin operacione për të nxjerrë gurë nga veshjet e mshikza e ujit, operacione për të heqë perden e syut, bajshin synetlleqe simbas ritit muhamedan etj. "Një me një kishim frangjyzën, heqjen e gurit dhe të perdesë së syrit" më thoshin dy xharenj pleq të këtij katundi, Thimi dhe Alush Muço.

Xharenjtë delshin zakonisht në fillim të prandverës (nga mueji mars e tutje) dhe qëndrojnë 5 a 6 muaj në kurbet. Shkojnë në grupe 2-3 vetash, të pajisun me mjetet e punës dhe me barna. Kryetari i grupit ishte xherahu, ndërsa ndihmësit quheshin çirakët e tij. Nga gjithë zejtarët e tjerë shetitës, xharenjtë, për vetë natyrën e punës së tyre, ishin ata që kishin nderim ma tepër në popull. Xharenjtë nuk flejnë kudo, po në dyert e para të katundit ose nëpër shtëpiat që kishin të sëmundë. Hajshin zakonisht së bashku me njerzit e familjes. Në çdo katund që shkojnë vijshin me pare një njeri që të thirrte: "*Erdhën xharenjtë, kush të ketë ndonjë sëmundë të ç'i filan vend*". Për sëmundjet e randa xherahun e merrshin nëpër shtëpia; ata që kishin ndonji plagë etj. grumbulloheshin te sheshi i kishës a i xhamisë, ku atakishin qëndrën (xharenjtë). Për çdo rast bajshin pazar simbas randësisë së sëmundjes. Për heqjen e perdes së syut merrshin 1/2—1 napolon, për nxjerrjen e gurëve 2-3 napolona. Ata merrshin përsipër jo vetëm të kryejshin operacione, po edhe të shërojnë sëmundje. Për këte qëllim përdorshin barna të ndryshme, që i përgatitshin pjesërisht vetë, pjesërisht nëpër farmaci.

Bualiotët bajshin edhe vaksina kundër lisë. Në kohën që ish as ftohtë as nxehtë, zakonisht në muajin prill e maj, delshin e shënojnë të vegjlit në llanë të dorës, afër palës së bërrylit. E pritshin me neshter dhe i vishin qelb. Qelbin e merrshin nga plaga e një të shënuemi dhe e rucjshin në një fyezë prej ashti të pulës, të cilën e vulosshin me dyllë. E nxiershin nga fyza me një si pendë, po prej ashti të shpendve.

Xharenjtë e Bualit kanë qenë të njoftun si specialistë për heqjen e gurëve dhe operacione të tjera.

Zanatin e xherahit e trashëgonte familja (vetëm meshkujt, se gratë nuk i afrojnë në këto punë). Nuk dinë të thonë se në ç'kohë e kanë nisë ta praktikojnë për herë të parë, a nga e kanë marrë këtë zanat; por dinë se asht shumë i vjetër. Në rrethin e Përmetit, ashtu si edhe në krahinat kufitare, në Zagorie, Lunxh etj., ka edhe katunde të tjera që ushtrojnë mjekësinë popullore. I pari i familjes së njoftun të Gjikaëve që kish shkue në Rumani, në fillim të shek. XVII-të, thohet se ka qenë mjek popullor.

Xharenjtë e Bualit i kishin zonat të ndame (shkojnë vit për vit në të njajtat krahina). Po të futesh ndonji tjetër në zonën e shokut, nuk e pranonte vendi.

Grupet e xharenjve, kur shkojshin për punë nëpër vende të ndryshme, merreshin vesh midis tyre me dogançen. Ustai e përdorte këtë gjuhë si mjet konsulte me ndihmësit e tij për përcaktimin e diagnozës së të sëmundit, për përcaktimin e pagesës etj.

Ashtu si edhe për zanatçitë e tjerë shetitës, një sferë e rëndomtë për përdorimin e dogançes nga xharenjtë ka qenë ajo e ushqimit.

Nji përdorim të veçantë ka pasë dogançja sidomos në katundet: Kaludh, Strëmbec, Kanikol, Pëllumbar, Draçovë, Gjinkar, Zhepë të rrëzës së Përmetit — një krahinë që gjendet rreth 30 km. nëlindje të Malshovës, midis rrugës Përmet-Leskovik. Banorët e këtyne katundeve kanë punue si sharraxhi e qymyrxhi, nëpër krahinat e ndryshme të vendit, me zona pyjore të gjana, si në pyjet e Hotovës, të Llogarasë, të Dukatit, të Gramshit, të Bërzheshit, të Qafshatmës, të Qafmurrës etj. si edhe në Greqi (Patër, Egjio, Koritho, Qato, Tripul, Argo etj.).

Sharraxhitë shkojshin grupe-grupe (në bylykë). Nji bylyk kishte 4-6 veta. Zakonisht 2 presin trupa, 3 punojnë me sharrë. Në krye të tij ishte *ustai*, që vendoste, në bashkëpunim me një ndihmës, për pajtimin e punës, ushqimin, fjetjen e bylykut. Të tjerët quheshin puntorë a çirakë. Sharraxhitë merreshin zakonisht me përgatitjen e landëve të ndërtimit për banesa, pritshin lisa në pyllë, shkurtoshin trupa 1,2,3,4 m. simbas nevojës që kishte i zoti i punës, përgatitshin dërrasa, patavra, breza, trenë, direktë etj. Nji bylyk mund të nxirrte deri më 80 dërrasa ose deri më 15 trenë në ditë. Paga bashë me copë.

Kushtet e jetesës së sharraxhive ishin të vështira. Jo vetëm puna e tyre ishte nga ma të lodhëshmet në krahësim me ate të zejtarëve të tjerë zetitës, por ata ishin shtrëngue të punojshin edhe nëpër pyje, larg katundeve, në vështirësi për fjetje, sigurimin e ushqimit etj. Verës flijshin jashtë, dimnit ndërtojshin ndonji kasolle në pyllë. Ushqimin ua siguronte i zoti i punës. Ndodhte ngandonjihërë që të punojshin edhe në katund, kur punëdhanësi e kish afue landën pranë shtëpisë (trupa etj. që çaheshin mandej në dërrasa, patavra, qepra, trenë). Edhe në të tilla raste sharraxhitë kalojshin një jetë të vështirë. Në folklor gjinden vargje që tregojnë përcmimin e vendasve kundrejt tyre: *Cinxi, minxi, marmulli, / opinga prej shakulli, / rretra prej uriqi, / ik se na fëlliqi.*

Sharraxhitë, mbrenda vendit, qëndrojshin në kurbet 3-6 muej. Stina ma e përshtatëshme për punën e tyre ishte vera dhe vjeshta (deri më 20 dhjetor). Në Greqi rrijshin edhe 1-2-3 vjet. Së këndejmi i dërgojshin fitimet familjes me çeka në bankë. Tashti sharraxhitë e Rrëzës janë në përgjithësi, puntorë të kooperativës punimdruri të Përmetit e të Gjirokastrës. Punojnë nëpër pyje shtetnore në skuadra nga 6 veta: 2 presin trupa, një laton, 3 punojnë sharrën (2 përposhtë e një sipër). Dy të parët presin trupat, i krasitin dhe i transportojnë në vendin e sharrës. I latimit i shkon në sëpatë trupat, i laton dhe i ban gati për sharrë. Tre të fundit i çajnë në dërrasa me trashësi të ndryshme dhe i stivojnë. Tashti punojnë 10 muej. Janarit e shkurtit, për shkak të dimnit, pushojnë.

Megjithëqë sharraxhitë dhe qymyrxhitë e Rrëzës e mbajnë të folmen e tyre të zanatit si të shpikun nga malshovitët ("Malëshova është mëmë e dogançes" më pohonte Misto Proko, një sharraxhi 50 vjeçar nga Kaludhi), rrëzotët e kanë përpunue dogançen në një shkallë të atillë, sa mund të quhet si një variant i pavarun i saj. Ata, jo vetëm që e kanë pasunue ate me një terminologji të pasun të zejës së tyre (*lovidhe*: sharrë, *lovidhar*: sharraxhi, *gjatës*: tra, *gjerje*: dërrasë, *leke*, *lekthinë*: sëpatë, *sqep*: sqepar, *lekthos*: latoj, *gdhend*, *lidhar*: brez, *mojtja*: patavra, *grojës*: dru etj.), por kanë tregue

nji inisiativë krijuese në përdorimin e shumë elementeve të zakonëshme të fondit leksikor. Në vend të fjalëve *i leshtë, polo, ngulës, mëngres, vardje, manxhë, kucëre* etj. që përdorin malshovitët për grunë, policë, konak, zotni, punë, gjellë, para etj. rrëzotët kanë krijuar fjalët: *halës, a koqës, shufërzi a shkopsës, thumbar, dish, foradhë, lapanxare, cellarë* etj. Ata e kanë diferencue gjuhën e tyre deri me një emërtim të veçantë: *lovidharçe (a e rruc lovidharçen: a e kupton gjuhën tonë — të sharraxhive — Siç u tha nga fjalët lovidhe: sharrë e lovidhar: sharraxhi).*

Lovidharçja, ashtu si edhe dogançja, gjen një përdorim të veçantë në të katër sferat që u përmendën për kallajxhitë: a) në ato të sigurimit të punës, b) në të ushtrimit të zejes — të udhëzimeve të kryetarit të bylykut mvartësve të tij për normat e punës dhe të marrëdhënieve të tyre me vendësit, c) në kushtet e sigurimit të ushqimit, fjetjes etj. ç) dhe në rrethanat e kapërximit të vështirësive, të rreziqeve që u delshin atyne përpara në kushtet e jetës së tyre endacake.

Sharraxhitë dhe qymyrxhitë e Rrëzës tregojnë shumë raste kapërximi rreziqesh me anë të dogançes.

Nji bylyk qymyrxhish po ktheheshin nga puna dhe i ze nata në nji katund. Aty venë re shenja të dyshimita. Njeni nga pjestarët e bylykut u thotë shokëve në dogançe: *Në këtë mojdë ja pëlçasin nomadë të thantë. E rrucën se ja pëlçasëm cellarë dhe do të na përfytn po mos dufrijmë* (Në këtë shtëpi ka njerëz të këqi. E kuptuen se kemi pare dhe do na vjedhin, po mos flemë).

Për studimin e shtrimitjes gjeografike të dogançes u mblodhën elemente të shkëputuna të kësaj së folmeje edhe në katunde të krahinës së Leskovikut. Në Biovizhdë u regjistruen pak glosa, ndërsa në Podë u ba nji punë ma sistematike. Poda asht nji katund i madh, që shtrihet në nji zonë malore në Veri të Leskovikut. Pamjaftueshmëria e tokës prodhuese i ka detyruar banorët e këtij katundi të merren edhe me ushtrimin e zejeve të ndryshme. Banorët e Podës i gjen sot si shkarpxhi, muratorë, rrobaqepës etj. Midis dy kategorive të zejeve të para, të cilat janë ushtruar zakonisht në kushte ambulante, ka qenë përdorë edhe dogançja. Simbas thanieve të pleqve, kjo gjuhë, që njihet ma tepër këtu me emnin *malshovitçe*, "është e vjedhur nga Malshova." Dhe me të vërtetë fondi leksikor i gjuhës së tyre përkon me ato të dogançes. Për t'u shprehë ma me saktësi, ai asht nji vazhdim nga përbanja leksikore dhe fonetike e fondit të lovidharçes — gjuhës së sharraxhive të Rrëzës — me të cilën katundet e Leskovikut janë kufitarë. Në fjalorin e mballomaxhive shetitës të Podës gjejmë vërtet elemente të njajta me të dogançes, si p.sh. *camosem, çoçulla, drangulloj, dufrij, fryj, gjatje, katërkëmbye, koçth, koraf, ngrecoj, shoros, thur*, por ka edhe elemente që nuk përkrijnë me te, si p.sh. *foradhë, forodhis, furrats, kësho, përfyt, rrethje, tortëzes, thumbës, thumbar*, të cilat si nga trajta ashtu edhe nga kuptimi, janë të njajta me lovidharçen (Dogançja e Malshovës përdor në vend të tyre fjalët *vardje, vardis, rrotës, boçko, qapoj, xhando, ngulës*). Asht për t'u vu në dukje se nji numër glosash të saj, si p.sh. *baltovë* (baltë,) *falje* (kishë, xhami), *kungullor*, (zyrtar), *lidhës* (mut), *pillos* (pi), *skëndje* (dërrasë), *shtriqe* (të holla), *tuge* (kokë), *vërce* (vajzë), *vup* (punoj shkel e shko), nuk kanë afri as me lovidharçen. Ka mundësi që ato të jenë frut i pasunimit dhe i zhvillimit të matejshëm që i bajnë të folmeve shoqnore grupet e ndryshme të zejtarve ambulantë. Por ka mundësi gjithashtu që ato të përfaqësojnë pikat e para të takimit të dogançes me të folmen e muratorve të Oparit, purishten. Prania e këtyne elementeve të fundit bahet edhe ma e madhe në nji lokalitet ma verior — që i afrohet edhe ma tepër territorit të purishtes — në katundin Shalës të krahinës së Kolonjës.

Muratorët e këtij katundi kanë gjithashtu të folmen e tyne të zanatit. Kjo, në shumicën e elementeve leksikore të saj, i përket dogançes (*dufrij, dyka re, dredhje, forfol, foradhe, fryj, gardh, gardhiot, gjonht, kastis, mboqth, mëngres, piqos, qëroj, rretheje, rrokan, sqepo, shapkar, shapkarje, shidh, shidhe, thur, xherroset*). Shumë prej këtyne elementeve kanë pësue ndonji farë ndryshimi në trajtën e jashtme - gjë që shpjegohet me largimin gjeografik prej burimit të gjuhës nanë (*dufrij* thohet *dufit, forfol* — *fofol, gjonth* — *gjone, çotë* — *kotë, mboqth* — *mbogja, pykos* — *piqos*), por në themel ato mbeten elemente të dogançes; prandaj e folmja e muratorëve të Shalësit mund të quhet si një nga pikat ma të skajta (të dogançes) në zonën verilindore. Ndonji element në fondin leksikor të kësaj së folmeje si *mëlis* (pushoj), *mullosi* (vdiq), *sabo* (mëngjez) duhet të vështrohen si rezultat i një krijimi të pavarun; por fjalët si *balash* (diell), *bime* (vajzë), *jaica* (vezë), *mbleko* (qumësht), *nashëll* (shkoj, iki), *peshqindje* (dritare), *rojka* (vezë), *spenell* (usta), *zavo* (keq), *zhidro-zhito* (grunë, misër), *zhivlla* (pare) janë huazime të drejtpërdrejta nga purishtja. Edhe këtu vihen re të njajtat fenomene me ato që konstatohen në fondin leksikor të dogançes: shndërrime fonetike, në ndonji rast edhe shndërrime në vetë kuptimin e fjalëve (*rojke* në purisht do të thotë punëdhënësi, ndërsa te muratorët e Shalësit ka marrë kuptimin e vezës etj.).

Përhapja e dogançes nga krahinat që mbahet si djepi i origjinës së saj, nga Malshova, në Bual, në Rrëzë, në Leskovik, Podë e deri në Shalë të Kolonjës, i detyrohet dinamizmit të kësaj së folmeje — shtrimjes së saj nëpërmjet të kontakteve të fqinjësisë. Por dogançen e gjejmë edhe në një pikë tjetër të zonës veriore të Jugut — në katundet Vërtop e Malshovë të Beratit. Sikurse asht thanë, këto të dy katunde mbahen me prejardhje nga Malshova e Përmetit. Të parët e tyne, për t'i shpëtue ndjekjeve të njerëzve të Ali Pashë Tepelenës, që kërkoshin t'i kthejshin në fenë islamike, u detyruen të lanë votrat e tyne familjare dhe të dynden në Berat. Sundimtari i abershem i këtij qyteti, Kurt Pasha, n'ate kohë kundërshtar i vezirit të Janinës, i priti mirë, i vendosi në vende ku ndodhen sot dhe u dha të drejtën e ushtrimit të zejeve të tyne në gjithë territorin e pashallëkut të tij. Pleqt e këtyne katundeve tregojnë se stërgjyshët e tyne të parë qenë kallajxhi dhe bashkë me këtë mjeshtri ata suellën nga vendi i origjinës edhe gjuhën e zanatit, dogançen. Tue u mbështetë në këto pohime, përhapja e dogançes në këtë zonë nuk duhet të jetë kushtëzue nga kontakte fqinjësie, por nga lidhjet gjenetike. Vërtopasit ushtruen me kohë edhe mjeshtëri të tjera si punimin e drunit, të ndërtimit të tavaneve, të tregëtisë ambulante. Dhe nëpër këto u përdor shpeshherë edhe dogançja. Mungesa e kontakteve me ndonji tjetër të folme shoqnore a me ndonji gjuhë tjetër pakicash kombëtare, që të mund të ushqente fondin e saj leksikor, ka shkaktue që dogançja e Vërtopit të mos arrijë ndonji farë zhvillimi të veçantë në krahasim me ate të Malshovës së Përmetit. Elementet themelore të leksikut të të dy këtyne të folmeve janë pothuajse të njajta. Nga tavanxhitë dhe kallajxhitë e Vërtopit kemi fjalë si i *bëjshëm, bishto, boçko, bozil, bozilkë, bragj, brajo, bujo, camos, cimagdh, cikulësi, çivrisem, çkërllh, çkërthes, çkërthos, çotë, çur, dufri, duno, dushkat, evllomadhë, forfol, forfolis, goro, gjonth, ilje, korkosurkë, kuce, kulare, legjos, lëkurje, majkush, malko, manxhë, mbathje, mjelje, mojdë, mostokuqe, mulo, nizo, panxhë, ja pëlças, pleros, potam, prokthi, prokie, qapoj, qezëroj, sello, sheros, (shëros), shkrumje, shtëngëza, tiko, trocit, tytës, thano, thanuqe, thumbar, thumbarxhi, thurje, vardis, vardje, xaribell, i zaganjepsur, zeno. Po të pranojmë se dogançja u suell në Vërtop nga themeluesit e këtij katundi, fjalët e naltpërmenduna duhet të mbahen edhe si elemente leksikore nga ma të vjetrat të fondit të dogançes së Malshovës (Përmet).*

Në rrethin e Përmetit kanë qenë vendosë kohë mbas kohe edhe mura-
torë e zejtarë të tjerë shetitës, të ardhun për punë nga krahina të Korçës,
ku flitet purishtja. Për të pamë zhvillimin e kësaj të fundit në kushtet
e veçimit nga vendi i origjinës dhe në ato të marrëdhënieve me një tjetër
të folme shoqnore, siç asht dogançja, si edhe për të studjue ndikimet reci-
proke midis tyre në këto kushte, mblodhëm materiale nga dy subjekte:
Mantio Priftanji, murator nga Trebicka, i vendosun në Përmet që në luftën
e parë botnore, dhe Sotir Naumi, gjithashtu murator, nga Orgocka, i vendo-
sun këtu rreth vitit 1920. Në shqyrtimin e materialeve të M. Priftanjit
vihet re se fondin themelor të fjalorit të tij e përmbajnë elemente të puri-
shites: *balash, bimez, bimth, çork, dërva, dollmë, fratell, fyk, fyke, gërrnie,
glendie, koran, koro, ksirenj, kuçav, lodh, lodhem, lukër, lukros, llove, llude,
mitre kosmara, ndriko, pravit-pulloj, pullos, pure, puritem, i puritur, qepë,
sorellë, tret, tymës, vino, xivë, xhombul, zahar, zornnik, zvaranik*. Fjalë të
fondit themelor ne quajmë sidomos fjalët si: *lodh, lodhem, lukër, lukros,*
që janë elemente bazë në ndërtimin e fjalive si edhe emërtimet e rrethit
intim familiar *fratell, sorellë, bimez, bimth, fyk, fyke* etj. Si rezultat i ma-
rëdhënieve me dogançën, në fjalorin e M. Priftanjit kanë hy nga
e fundit fjalët: *i bëshmë, brambull, (frambull), caqis, dredh, fryj, kol (i kolmë),
qëroj, rrokan, rrokanis, rruc, saraqole, shkrumbje, vakroj*. Ndërsa elementet
që do të epen ma poshtë, të cilat nuk i gjejmë as në dogançën, as në purisht,
ka mundësi të jenë krijime të pavaruna të këtyne subjekteve, në një anë të
shkëputun nga vendi i origjinës, dhe në tjetrën të paasimilue me akoma
plotësisht ne vendbanimin e tyre të ri: *çimkë, të dëgjuarit, të dhirtë, fleme,
kapë, këlyshe, kërrbithje, të lagur, i lehtë, mjekërs, mullos, të pamit, plloçë,
shollë, thartoj, i thatë, i veshur, vithkëlyshe*.

Edhe në fjalorin e Sotir Naunit fjalët e fondit themelor i përkasin
purishtes: *bëçe, bimth, çorkë, dervë, dardhare, dredh, fyk, fyke, goxho, gërrnie,
kokëpështjellë, koran, loth, lodhem, lukros, lukur, përcille, pravit, psomozitër,
saliarap, sirenjë, tret, tymës*. Kurse një numër fjalësh ka mundësi të jenë ma-
rrë nga dogançja: *cakure, cello, citis, kol, saraqole, shapkat, shkrep, vakëroj*.

Elemente të dogançës kanë arritë deri në rrethin e kallajxhive të zonave
qendrore dhe veriore të vendit (në kallajxhitë e Elbasanit, Kavajës, Durr-
sit, Tiranës, Shkodrës). Përhapja e këtyne elementeve në këto rrethe nuk
ka të bajë me dinamikën e vetë së folmes, me shtrimjen e saj nga marrë-
dhania të fqinjësisë. Elemente të tilla u çuen atje nga marrëdhania të tjera.
Kallajxhitë përmetarë, gjatë kurbetit të tyre stinor nëpër krahinat e nalt-
përmenduna, kishin kontakte me kallajxhitë e bakraxhitë vendas. Ata
bashkoheshin nëpër panairë dhe festa të tjera lokale, ku shitshin objektet
e përpunueme. Kallajxhitë ambulante i çonte puna të ndaleshin shpeshherë
në këto qendra për furnizimin me materiale dhe për nevoja të ndryshme
jetësore. Në të tilla rrethana bakraxhitë vendas u vunë në dijeni dhe
përvehtësuen edhe ndonji element të gjuhës së tyre. Simbas të thanave
të Jorgji Fullanit, plak rreth 90 vjeç, i cili ka qenë marrë që në moshë të re
me zejen e bakërpunuesit, midis bakraxhive të Elbasanit, para 60-70 vjetsh
kanë qenë njohët disa fjalë të dogançës. Ai sjell ndër mend, akoma sot, nga
kjo gjuhë fjalë si: *thanuqe shkrumbje, dredh, fryj, mojdë, mavro, duno,
gjonh*. Ndonji element të saj si *thanuqe, dredh, fryj*, e kemi jetë ed e midis
kallajxhive kavajas, tiranas e shkodranë. Por duhet theksue se këto ele-
mente mbetën gjithmonë në sferën e një kurioziteti të thjeshtë, nuk mua-
rën karakterin e një fjalori aktiv, nuk u ngritën, në asnjë prej këtyne
qendrave, në nivelin e një të folmeje të plotë me aftësi komunikuese
të pavarun.

II. Analiza e materialit leksikor

Me të drejtë të folmet shoqnore janë konsiderue si një grumbullim fjalësh të veçanta të krijueme nga brumi i gjuhës amtare, ose nga burime të tjera, të cilat lidhen midis tyre në bazë të skemave dhe rregullave të strukturës së gjuhës nanë. Sikurse do të shohim edhe ma poshtë, ne nuk gjejmë në të folmet shoqnore as edhe një rregull gramatikor, as edhe një skemë lakimi, as edhe një paradigme të vetme që të ndryshojë prej rregullave, normave etj. të gjuhës së përbashkët. Prandaj objekti kryesor i studimit të këtyne të folmeve, mbetet fjalori i tyre — gjanësia e elementeve leksikore, kategoritë gramatikore të cilave u përkasin këto elemente, mënyra e formimit, përmbajtja semantike e tyre etj.

Dogança paraqit një fond leksikor të pasun. Nga të 12 qendrat ku u banë kërkime për mbledhjen e elementeve të kësaj së folmeje, u regjistruen rreth 1500 fjalë, të cilat, mbasi u grupuen, dhanë rreth 660 elemente të ndryshme (shih pjesën e fjalorit). Sasia e fjalëve të regjistrueme në çdo lokalitet, natyrisht, ka qenë e kushtëzue në radhë të parë nga shkalla e përdorimit të kësaj së folmeje, por edhe nga koha që asht pasë në dispozicion për kërkim të tyre në këtë ose ato qendër. Shumica e materialit të regjistruem, siç shihet në pjesën e Fjalorit, i takon fshatrave: Malshovë, Grabovë, Brezhdan, Leskaj, Limar, dhe fshatrave të Rrëzës së Përmetit: Kaludh e Strëmbec. Elementet e ardhuna nga qendrat e tjera janë të kufizueme dhe kryesisht me karakter informativ për studimin e shtrimjes gjeografike të fjalëve, të gjendjes, zhvillimit dhe ndryshimeve semantike, fonetike etj. që pësojnë ato në gojë të grupeve të ndryshme shoqnore.

Fondin leksikor të dogançes e përbajnë termet që lidhen me zejet e folësve të kësaj gjuhe: me kallajxhillëkun, mjeksinë popullore, punimin e drunit, zejen e muratorit etj.; emërtimi i mjeteve të punës, i landëve që përdoren për punim, i proceseve të prodhimit, i objekteve të përpunueme, vendqëndrimi: etj.: *mauro, umuri, lovidhar, pure, kloshe, tytës, kastis, drangujloj, shapkarje, kokadhe, pesqindje, firje, dalldër, katërkëmbje, kapuq, palesht, llash, baltovë, thumbar, ngulës, konës*.

Një vend të randësishëm në fondin leksikor të dogançes ze edhe ambienti me të cilin kanë qenë në marrëdhanie të drejtpërdrejta zejtarët shetitës: punëdhanësit dhe rrethi familiar i tyre, njerëzit që kishin lidhje me punimet, me interesat e tyre profesionale, qeveritarët, keqbasit etj. *dishi, dishari, shanua, shanuq, këmbësi, cimëdhenjtë, mëngresi, këcuret, cellarët, ftoj, pleros, pllait, ngrecon, thanos, camos, qapoj, i cimbërt, i bëjshëm, kol, i thanë, nomat, Ckulo, vëngo, kungullor, shkopsë, shufërzi, dedegerrua, praho*. Sfera të tjera që kanë zgjanue fondin leksikor të dogançes janë trupi i njeriut me shqiset, nevojat materiale (të ushqimit, veshmbathjes etj.), rrethi familjar, marrëdhanië e jetës bashkshortore, të gjinisë, të fqinjësisë etj.: *trocit, duqet, erëza, sporengëza, mëngresja, dredhja, panxha shkelljet, lëkurjet, majkush, majkushe, fillo, fillush, fillushkë, prokje, prokje e cipëzosur, shidh, shidhe, rrethje, rrethos, përgëzoj, qapoj, u fyp, u pykos*.

Në fondin e dogançes gjejmë fjalë të fenomeneve atmosferike, të ambientit gjeografik, të florës, faunës etj. *duno (shi), bërnigë, çkulje, ilo, leko, merjë, xherr, leje, evllomadhë, minë, kronj, vuno, gardh, gardh i bëshëm, mboqës, halës, koqës, çotë, çotak, bishto, fype, bozhure, bolo, bozil, bozilë, dalldër, katërkëmbie*.

Duhet të kemi parasysh se ashtu sikur ndodh për gjuhën e përbashkët, edhe në fjalorin e dogançes disa elemente leksikore janë të fondit aktiv, që përdoren vazhdimisht në marrëdhanië e jetës së përditëshme të zejes.

Të tilla fjalë për dogançen janë *camos*, *citis*, *çkërth*, *çkrij*, *dredh*, *dufrinj*, *duno*, *fryj*, *ftoj*, *fyp*, *foradhë*, *gris*, *gjonth*, *kastis*, *këmhës*, *mëngres*, *majkushe*, *mojdë*, *vardis*, *vardje* etj. Disa fjalë si terminologjitë e zejeve etj. rrojnë vetëm në ushtruesit e tyne; disa i përkasin fondit pasiv dhe njihen vetëm nga një numër i kufizuem njerëzish. Nga materialet e mbledhuna konstatohet se numri i koncepteve që i përgjigjet fjalorit të dogançes, arrin deri në rreth 1000. Disa nga fjalët e fondit themelor të saj kanë shpeshherë ma tepër se një kuptim. Zgjanimi i kuptimit në të tilla raste bahet mbi të njaj-tën bazë semantike dhe skemë që ka qenë shfrytëzue për përfitimim e kuptimit të parë. Kështu p.sh. fjala *duno* përdoret me kuptimin e ujit edhe të shiut, *babje* për torbë edhe për thes; *çotak* për gjel (këndez) edhe për napolon (se napolonët flori kishin zakonisht figurën e një gjeti); *fëpe*: musteqe dhe mace; *fytylo*: tëlyen e voj; *gardh* dhe *gardh*, i *bëjshëm*: katunddhe kryeqytet; *garho*: elb e tagji; *halës*: peshk e grunë; *ka'adhe*: kusi edhe tepsi; *koçth*: djathë, gjizë; *logos*: shoh, kërkonj; *llash*: lesh, baltë, sheqer; *merje*: ditë dhe javë; *peko*: pekmez e gjak; *pesqindje*: dritare dhe portë; *pëlcas*: jam, kam, *përfyt*: gjej, za, kap, vjedh; *rotës*: mulli dhe automobil; *rrute*: mjekër dhe mace; *rrutës*: hoxhë, dervish etj.

Një tjetër fenomen që karakterizon dogançen, krahas polisemisë, asht poliforma, trajtat e ndryshme që kanë marrë elementet leksikore të saj. Shumësia e formave ashtu si edhe krijimi i disa fjalëve të ndryshme për të njëjtin koncept, e ka burimin te karakteri i mbyllun i njohjes dhe i përdorimit të të folmeve shoqnore. Këto të folme jetojnë në mënyrë intime, ndër grupe të kufizueme njerëzish, që bien rrallë në kontakt me një tjetrin, qoftë nga shkak i largësisë gjeografike, qoftë nga ndryshimi i interesave të tyne profesionale. Kallajxhitë e Brezhdanit, sharraxhitë e Kaludhit e mballomaxhitë e Podës nuk i çon puna të bashkohen dhe të përdorin dogançen si mjet komunikimi midis tyne. Këta grupe zejtarësh shetitës e ushtrojnë veprimtarinë e tyne në zona të ndryshme. Jo vetëm kaq, po edhe midis pjestarëve të një grupi zejtarësh të të njëjtit profesion nuk paraqiten kushte të një bashkëjetese të vazhdueshme. Kallajxhitë, ashtu si edhe sharraxhitë, xherahët etj. përndahen në krahina të ndryshme në grupe dy a ma shumë vetësh, të cilët punojnë për një kohë të gjatë larg një tjetrit. Asht e natyrëshme që në të tilla kushte veçimi të lindin shpeshherë trajta. kuptime, dhe fjalë me një zhvillim të pavarun. Këte gjendje e favorizojnë improvizimet subjektive, sidomos të njerëzve që nuk e njohim mirë dogançen. Gjithashtu ndikojnë në procesin e trajtave të ndryshme edhe larmitë dialektore të gjuhës amtare që shërbejnë si bazë në krijimin e elementeve leksikore të të folmeve shoqnore. Ma poshtë po apim disa shembulla të formave të ndryshme me të cilat paraqiten disa fjalë të dogançes: *dufit*, *dufri*, *dufrinj*, *dufrit* (fle); *dushkaj*, *dushkas*, *dushkat*, *dushkatem* (shkoj); *forfol*, *fofol* (zjarr); *garth*, *gardho* (katund); *gjatë*, *gjatëz*, *gjatje* (udhë); *gjonth*, *gjon*, *gjone*, (bukë); *koçth*, *koç*, *të kotë*, *të koçthitë* (djathë, gizë); *korafe*, *korafje*, *koravoje* (arë); *kuce*, *kucëre*, *kucërit* (pare); *luqo*, *lyqo*, *lyqyn* (tëlyen); *mboqës*, *mboqe*, *mboqje*, *mboqths*, *mbojths* (misër); *mojdhë*, *mojdë*, *mujdë*, *mujdhë* (shtëpi); *panxhë*, *pançë*, *pangjë* (duer); *proço*, *proçkës*, *proçkth* (lik); *xaro*, *xaribell*, *xarabell*, *xërro*, *xërre* (dhalltë).

Me ndryshimet e formës lidhen edhe shumë fenomene fonetike, të cilat janë pasoja të dinamikës së fenomeneve të tilla që veprojnë në gjuhën amtare. Në materialet e dogançes vihen re raste të shkëmbimit të *y* në *i*: *pykos-pikos*, *piqos*; asimilime e disimilime zanoresh e bashkëtingëlloresh: *kucëre-kucure-këcure*, *legos-logos*, *cfyts-cfyc*; shkëmbime bashkëtingëlloresh: *përfyrt-pëlfyt*; *ngrecoj-ngresoj*; *evdhomadhë-evllomadhë*, *drangulloj-drangudhoj*,

kokodhar-kokollar, lidhos-lillos, xadillos-xadidhos; raste metatezash: *çivri-sem-çivri-sem, jazëlldi-jallëzdi* etj. Trajta të tilla jetojnë krahas njana tjetrës, në përshtatje me ndryshimet fonetike të të folmeve territoriale përkatëse.

Aftësia krijuese në të folmet shoqnore përqëndrohet vetëm në fushën e formimit të elementeve të leksikut. Bile edhe këtu nuk përfshihen të gjitha pjesët e ligjeratës dhe as paraqitet ndonji përpjestim i harmonishëm midis formimeve që u përkasin kategorive të ndryshme gramatikore. Numri ma i madh i elementeve të leksikut të dogançes, ashtu siç ndodh edhe në të folmet e tjera shoqnore, i përket emnave; në një sasi ma të kufizueme janë mbiemnat dhe foljet; fare të paktë janë numrorët dhe ndajfoljet; ndërsa për lidhëzat, nyjet, parafjalët e pasthirmat nuk haset asnjë krijim i veçantë, por shfrytëzohen gjithmonë ato të gjuhës së përbashkët. Po në këtë mënyrë shfrytëzohen nga kjo gjuhë edhe krejt rregullat morfologjike e sintaktike, normat, skemat e trajtat që veprojnë në ndërtimin e gjinisë, numrit, rrasave të emnave e mbiemnave, në zgjedhimin e foljeve, formimin e fjalëve, në lidhjen e tyre sintaktike etj.

Dogançja ka të tri gjinitë e emnave: gjininë mashkullore, femnore dhe asnjane. Në formimin e emnave mashkullore asht shfrytëzue në një shkallë mjaft të gjanë skema e emnave të tipit që mbarojnë me -o në të pashquemen dhe -ua në të shquemen. Kjo ndodh ndoshta, nga shkaku se kjo skemë përdoret edhe për formimin e emnave femnore. Diferencimet e hollësishme dhe përpunimet analitike nuk janë të zakonëshme për të folmet shoqnore. Si shembulla të emnave të kësaj kategorie kemi: *balo-ua, besho-ua, bishto-ua, boçko-ua, çilo-ua, çito-ua, duno-ua, kështo-ua, kullo-ua, mbleko-ua, nafto-ua, niko-ua, nano-ua, pano-ua, piro-ua, praho-ua, sabo-ua, sallo-ua, shano-ua*. Nga emnat femnore tipi ma i rëndomtë asht ai që formohet me mbrapashtesën -je: *çkulje, djegie, dredhje, fypje, gjatje, katërkëmbje, lëkurje, rrjedhje, shapkarje, shkelje, shkrumbje, tokje, tytje, vardje*, etj. Emnat asnjane formohen kryesisht me nyjën të: *tëbëzit, tëbidës, tërocit*, etj.

Fenomen mjaft i rëndomtë në formimin e emnave të dogançes asht *ambigenia*. Nji tog emnash të kësaj së folmje kanë trajta të të dy gjinive: të gjinisë mashkullore dhe të femnores. Edhe ky fenomen mendojmë ta ketë burimin te inisiativat e nji krijimi subjektiv si edhe te mungesa e nji kontakti të rregullt midis grupeve për përpunimin e trajtave unike në kategoritë e ndryshme gramatikore. Si shembuj për këtë fenomen po sjellim emnat *dalldër-i* edhe *dalldëre-ja*, *kaniq-i* — *kaniqe-ja*, *kronj-i* — *kronjë-a*, *kucër-i* — *kucëre-t*, *mboqës-i* — *mboqeja*, *xerro-ua*, — *xërre-ja*, *xherr-i* — *xherre-ja*.

Në dogançet veprojnë po ato rregulla të gjuhës së përbashkët në formimin e emnave të gjinisë mashkullore nga gjinia femnore: *çotë-a* (pulë) — *çotak-u*, *a çotash-i* (gjel); *moço-ja*, (f.) dhe *moçkan-i* (m.) ose anasjelltas për formimin e emnave femnore nga mashkullorët me mbaresat o mbrapashtesat -e-kë etj. *këmbës* (burri) — *këmbëse* (grueja), *bozil-i* (kau) *bozilkë-ka* (lopa). I njajti fenomen ndodh edhe për formimin e shumësit, simbas rregullave të gjuhës së përbashkët: *cimath-cimëdhenj*, *syzi -syzes*, *tortëzi -tortëzes*, *zhapëzi -zhapëzes*.

Formimet foljore në krahasin me pjesët e tjera të ligjeratës janë të shumta. Mbas emnave, mund të thomi, se kjo asht kategoria gramatikore ma e gjanë në fondin leksikor të dogançes. Afër 1/5 e fjalëve të saj (rreth 115 fjalë) i përkasin kësaj kategorie. Duhet shtue se nji numur prej tyre ka ma tepër se nji kuptim. Folje me karakter të përgjithshëm si: *citis*, *kastis*, *çkërth*, *dreth*, *thur*, *lidhos*, *drangulloj*, *shoros*, *pëlças* etj. vishen me kuptime të ndryshme. Në gjanësinë e numurit të foljeve dhe në zgjanimin e kuptimit të tyre, qëndron edhe epërsia e aftësisë shprehëse të dogançes kundrejt

të folmeve tona shoqnore të tjera. Nga pikpamja e ndërtimit në këto shfrytëzohen pothuajse të gjitha mbrapashtesat e zakonëshme foljore të gjuhës së përbashkët: *-is-*: *astis, bogdanis, caqis, citis, copis, çkëqis — çkëqit, dufrit, foradhís, forfolís, kastís, mëlís, rokanís, skupís, umurís, vaptís, vardís, eps: dërteps, dushqeps, strungjeps, vërzheps, xhydynjeps;* *-oj-*: *çfilloj, drangulloj, ngrecoj, qapoj, qezëroj, qëroj, rrethoj, rrucoj, uj këroj;* *-os-*: *çfiros, çfytos, çipëzos, çitos, çapallos, çfiros, çkëthos, çfiros, karrabos, krapos, kuspullos, legos, lekthos, lidhos, llugos, mullos, pesqindos, pikos, pillos, pleros, shoros, shtëngos, tripos, thanos, thuros, valltos, xadillos, zogos.*

Nji numër foljesh përdoren në trajtën e zakonëshme të gjuhës amtare: *gjerr, çkrij, çkul, dreth, fryj, gris, mërxej, ngjesh, pëlca, përgëztoj, pështjell shtyt;* ndërsa nji numër tjetër merr trajtën e foljeve mesore: *allaksem, camosem, -citem, cobirem, çivrisem, forfolitem, ngjatem, qestritem, xbardhem, xenosem, xhvishem, zaganjosem, zbardhem.*

Në zgjedhimin e foljeve ndiqen krejt skemat e zgjedhimeve të gjuhës së përbashkët:

I. I tanishmi — *forfolís* (për të tri vetat e njejsit), *forfolísim, forfolísni, forfolísin;* aoristi: *forfolísa, forfolíse, forfolísi, forfolísëm forfolísët, forfolísën;* e pakryemja: *forolísnja, forolísnje, forolístje, forolísnim, forolísnit, forolísnin.*

II. I tanishmi: *dufrit, përfyt, dushkat; pëlca, strungas;* aoristi: *dufrita, përfyta, dushkata; pëlcita, strungita.*

III. I tanishmi: *fryj, ftoj, mërxej,* aoristi: *fryva, ftova; mërxeva, dëfrevë.* Nëpër skema të tilla treten edhe folje që rruajnë drejtpërsëdrejti trajta të huajtura nga gjuhë të tjera si p.sh. folja *nashell,* e cila zgjedhohet në analogji me foljen *pështjell.*

Ligjëratat në të folmet shoqnore nuk ka ngjyra të holla stilistike, nuk karakterizohet nga larmi ngjyrash e formash të tërthorta; prandaj edhe kohët foljore që futen na tepër në punë këtu janë kohët themelore: e tanishmja, aoristi, e pakryemja, e ardhëshmja e mënyrës dëftore; e tanishmja dhe e pakryemja e lidhore; paskajorja. Mënyra kushtore dhe habitore përdoren rrallë; ndërsa dëshirorja pothuajse nuk përdoret fare.

Në formimin e fjalëve janë futë fort pak në përdorim parashtesat: *palesht, pëlfyt, përfyt, përgëzonj.* Përkundrazi janë përdorë gjanësisht mbrapashtesat. Mbrapashtesat na të rëndomta janë: *ar- are - bykare, lidhar, lovidhar, thumbar;-ak — çotak; -çe — dogançe, lovidharçe; -ëroj — uj këroj;* mbrapashtesa e emnave veprues *-ës — halës, këmbës, koqës, lidhës, ngulës, qepës, rrotës, rrutës, syrës, shkumbës, tytës, ;* mbrapashtesa e emnave femnorë *-je — gjatje, heqje, lëkurje, ngulje, rrjedhje, mjelje;* mbrapashtesa zvogëluese e gjinisë femnore *-kë — fillushkë, lëpushkë, mëngreskë;* mbrapashtesat foljore *-oj, -os — çfilloj, çamos, firos, lidhos, llugos, pesqindos, plehros, qapos, rrethos, xherros;* mbrapashtesa e emnave kolektivë *-ri — Çkulëri, Itëri, nizëri, Thumbëri, Vëxgëri;* mbrapashtesa e mbiemrave: *i leshtë, i toptë, i thantë;* mbrapashtesa zvogëluese e gjinisë mashkullore *-th: gjonth;* mbrapashtesa pejorative *-uq — uqe: nafluq, shanuq, thanuqe;* mbrapashtesa e burimit turk *-xhi: tekëthaxhi, thumbarxhi;* mbrapashtesa zvogëluese ose me funksion përkëdhelje *-zë — babëz, bizëz, gjatës, koqez, pojokëlyshëz, shtengëz, togëz, xhubzë.* Në nji shkallë të gjanë janë përdorë në këtë folme edhe tipa kompozitash të ndryshme: *katërkëmbje, këmbëviçe, mostokuqe, pojokëlyshëz, shufëzi, tortëzi, zhapëzëzë, zhapëzi.*

Interesant janë ecunitë që ndiqen në fushën semantike për veshjen e fjalëve me kuptime të reja. Sikurse asht thanë, brumin kryesor për krijimin e leksikut të tyre të folmet shoqnore e marrin nga gjuha amtare. Në përcaktimin e kuptimit të ri të fjalëve ndiqet kaq shumë skema e rrugë, sa asht

e zorshme të bash një klasifikim të larmisë së plotë të tyre. Ne do të apim ma poshtë disa prej këtyne ecnive kryesore që janë ndjekë nga dogançja për formimin e fjalorit të saj. Ka elemente leksikore të gjuhës amtare që janë futë në këtë fjalor pa asnjë ndryshim trajte e kuptimi. Këto janë fjalë të rralla të të folmeve krahinore, arkaizma ose fjalë të huajtuna nga të folmet e Veriut. Të tilla fjalë që përdoren pothuajse me të njëjtën trajtë e kuptim janë: *bozil*, *bubë*, *çakure* (edhe *cekure*), *cingo*, *ço*, *kalidhe*, *këmbës*, *lëpushkë*, *liko*, *mbathje*, *mëngër*, *popël*, *shidh*, *shirk*, *sqile*, *tesha*, *vardis*. Mjaft i praktikuem në zgjanimin e fondit leksikor të dogançes asht përdorimi i trajtave të shkurtueme të fjalëve. Të kësaj kategorie janë sidomos emnat gjeografikë — të qyteteve (*Bero* — Berati, *Firo* — Fieri, *Këlçua* — Këlcyra etj.), të lumejve (*Shkumbo* — Shkumbini, *Shasho* — Shashica), të katundevet (*Podò* — Podgorani, *Zhulo* — Zhulati, *Himo* — Himara); elementet e reja të teknikës, të jetës politike etj.: *aro* — aroplani, *trakto-ua* — traktori, *mitro* — mitrolozi, *partua* — partia, *partot* — partizanët, *ballot* — ballistat, *nazot* — nazistët. Sikurse shihet, kuptimi në këtë kategori fjalësh mbetet krejt i pandryshueshëm.

Ka fjalë të tjera të gjuhës amtare që rrujën vetëm trajtën, kurse kuptimin jo. Ato janë veshë me kuptime të reja të afërta me kuptimin e maparshëm bazë. Kështu fjala *i bëshëm* asht përdorë me kuptimin "i madh"; *çkrij* me kuptimin "blej, marr"; *fryj* — shkoj; *mërxej-la*, pushoj; *përgëzuj* — njoh; *qëroj* — marr; *syzi* — ulli; *shtyt* — shes; *xbardhem* — lahem.

Disa fjalë janë krijime onomatopeike: *çito*, *drangulloy*, *lluqos*, *xurxullimë*.

Formimi i kuptimit të fjalëve mbështetet kryesisht mbi tiparet e përbashkëta të konceptit bazë me konceptin e ri që formohet. Këto procese metaforike mund të bazohen mbi një tipar karakteristik të ndijimeve parimore: *cërne*, *koqin*, *palesht*, *syzi*, *shkrumbje*, *zhapëzi*; të ndijimeve ndëgjimore: *tokje*; të shijeve: *djegje*, *i thantë* (i tharët). Të zakonëshme janë krijimet semantike në bazë të ngjajshmënisë së formës: *bërniqe*, *gjatje*, *gjerje*, *halës*, *katërkëmbje*, *kogez*, *gjalpishte*, *lëkurje*, *qepës*, *rrethje*, *rrotës*, *zhapë*; ngjajshmënisë së landës: *duno*, *gjalp* (truni) *shtëngëz*; ngjajshmënisë së veprimt: *erëzë*, *falje*, *furratës*, *kopaçe*, *lëpirës*, *lidhar*, *mbytë*, *mjelje*, *ndjellës*, *ngulës*, *përfyt*, *pikos*, *pleros*, *rrejdhe*, *shkelje*, *shkopës*, *shkumbës*, *shufërzi*, *ujkëron*. Ka shumë raste kur kuptimi i ri bazohet mbi sinekdokën: *bishto* (qen); mbi ngjajshmëninë e prejardhjes së objektit; *pemojkë* (vezë); mbi ngjajshmëninë e prejardhjes së objektit; *pemojkë* (vezë); mbi ngjajshmëninë e moshës a kohës që i përkasin konceptet: *zogës* (copë). Në ndonji rast kuptimi i ri epet me rezultatin në vend të veprimt (*zbardhem*) (lahem) ose anasjelltas me veprimin në vend të objektit: *dredhje* (ushqim). Ka raste kur shfrytëzohen tipare fizike të veçanta të një njeriu të caktuem: *çaço* (topall; nga një farë Çaçi që kish çenë çalaman); besime popullore dhe legjenda për vende gjeografike: *Petraniku*, *Hinga*, *Zasteni*, etj.

Me interes do të ishte të shtrohej edhe problemi i ndikimit që ka ushtruar dogançja mbi gjuhën e përbashkët. Ky ndikim, asht i natyrshëm, që do të ndihej ma tepër në të folmet lokale të krahinave, ku rron gjeografikisht dogançja. Nga krahasimi i elementeve leksikore të fjalorit të P. Tases, (1), që paraqit një numur të mirë fjalësh të rralla nga krahinat e Jugut dhe sidomos nga rrethi i Përmetit, dhe nga disa verejtje tonat mbi të folmet e këtij të fundit, shihet se dogançja nuk ka kaluar pa lanë gjurmat e saj në fondin leksikor të gjuhës amtare. Këto ndikime mund të mblidhen në dy kategori — në pasunimin e fjalorit lokal me: a) ngjyra të reja kuptimi të fjalëve egzistuese dhe b) me fjalë të tjera të veçanta.

1) Pano Tase. Visaret e Kombit, vëll. XII Fjalorth i ri. Tiranë 1941.

a) Kuptimi figurativ që shënon Fjalori i Institutit të Shkencave për foljen fryj "fryu: ua mbathi këmbëve, iku" neve na duket si një ngjyrë kuptimi e huajtur nga doganca. I tillë na duket edhe kuptimi figurativ që epet po në këtë fjalor për fjalën rokan (f. 467) "njeri që të mërzit me fjalë a me gjërat që të kërkon". Në fjalorin e doganës si fjala fryj ashtu edhe fjala rokan njihen si fjalë të fondit themelor me këto vështrime. Tjetër rast i kësaj nartyre mund të merret kuptimi figurativ me të cilin asht zgjanue folja thur në disa krahina: mos e zgjat, po thurja edhe ik (bane një punë shpejt e shpejt dhe shkel e shko). Edhe ky vështrim formon gjithashtu kuptimin bazë të kësaj fjale për fjalorin e doganës.

b) Në kategorinë e dytë janë për t'u shënue fjalët: çkërth, lidhos, umuri, xeno. E para ka një përdorim të gjanë në të folmen e zejtarve të Përmetit (njihen edhe trajtat çkërthos, çkëthos, çkiquit, si edhe emnat çkërthës, çkiquolle, mbiemni i çkërthur etj.) Në fjalorin e P. Tases epen si fjalë dialektale çkëthem, çkëth, çkëthëtore me të njëjtat vështrime që kanë edhe në të folmet shoqnore. Tue u mbështetë në përdorimin e gjanë dhe produktivitetin që ka marrë ky element leksikor në këto të fundit, në faktin që nuk gjinden në fjalorët e tjerë të shqipes, si edhe në vetë kuptimin pejorativ të fjalës, mund të thohet se ajo asht një krijim i të folmeve shoqnore, që ka kalue mandej në leksikon dialektal. E njëjta gja mund të thohet edhe për fjalën lidhos që rron në doganë me trajta dhe formime leksikore të ndryshme (lillos, lidhje, lidhës); ndërsa në fjalorin e P. Tases epet me një vështrim të vetëm — të njëjtë me atë të doganës, — kurse në fjalorët e tjerë mungon. Fjalën umuri, që përdoret nga xharenjtë e Bualit me kuptimin e xherahut, e mjekut popullor, e kemi regjistruë në disa raste të ndryshme në të folmen e Përmetit: "filani është umuri"; "ka ardhur një umuri", "e ka t'anë umuri", "e shëroi një umuri". Në rrethin e xharenjëve, veç kuptimit të sipërm, kjo fjalë ka edhe kuptimin e trunit, të mëndjes: Filani ja pëlçet me umuri (filani asht me tru, me mend). Midis tyre jeton edhe folja umuris me kuptimin "baj xherahllëk": Umuris gardhjeve (ban xherahllëk katundeve).

Fjala xeno në fjalorin e doganës rron si emën: mos ki xeno se ua thur unë (mos ki frikë se ua ndreq unë); edhe si folje: mavrua u xenos e i rokanisi... (kallajxhiu u friksue dhe i tha...). Ky krijim i grupeve shoqnore asht regjistruë në fjalorin e P. Tases (f. 203) si fjalë me një kuptim të paqartë (me pikpyetje), por, nga shembujt e shënuem nën te, kuptohet se nuk asht tjetër veçse fjala frikë e doganës (nga frika më venë xeno — s'ma mba, kam frikë s'kam guxim; të venë xeno nga akëcili — i ke frikën, i trembe akëcilit, s'ta mba t'i dalish përpara).

Në një kategori të tretë mund të përmbliidhen disa fjalë të veçanta, të cilave nuk mund t'u përcaktohet lehtë prejardhja. Të tilla janë p.sh. fjalët i kolm, e kolme, shanuq, shapkar, xhydo, dhe ndonji tjetër. Fjala i kolm, e kolme ka një përdorim mjaft të gjanë në doganën. Këtu ajo jeton edhe si një formim ndajfoljor. Tue u mbështetë në këtë fakt, mund të thuhet se kemi të bajmë këtu me një krijim të të folmeve shoqnore. Por, kur sheh se një fjalë e tillë rron edhe në të folme të tjera krahinore (Përmet, Labëri, etj.), mund të mendohet edhe për një depërtim të kundërt (të ketë hy në doganë nga fjalori dialektal). E paqartë asht edhe prejardhja e fjalës shanuq, e cila në doganë njihet me kuptimin e të krishtenit, kurse në fjalorin e Tases (f. 16) me kuptimin shushk. Fjalët shapkar, shapkarje, (laknor, tepsi) si edhe fjala xhydo (lypës) të doganës rrojnë me kuptime të afërta edhe në ndonji të folme krahinore të Jugut.

1) Fjalor i Gjuhës Shqipe. Tiranë 1954 f. 129.

Për zgjanimin e fondit leksikor të dogançes janë shfrytëzue në një shkallë relativisht të gjanë, edhe gjuhët e huaja. Ma tepër elemente janë marrë nga gjuha greke. Pozita gjeografike e dogançes, përhapja e saj në zona të skajta, siç janë Përmeti dhe Leskoviku, ndikimi kulturor dhe fetar në bartësit e saj — të cilët i përkasin kryesisht besimit të krishtenë, kanë shkaktue që të huahen elemente të ndryshme nga greqishtja. Përveç fushës së emrave, mbiemrave e foljeve, këto janë fjalë të rralla, sidomos të kategorive gramatikore që nuk kanë një zhvillim të veçantë në dogançe, si p.sh. të formimeve, ndajfoljore. Nga elementet greke të dogançes shënojmë: *allos, aniks, apakth, camos, dhondia, evdhomadhe, gambro, hara, iljo, koqin, kronjë, mavro, merje, meso, methavrio, okso, qinurio, vuno, zahar, zogos*. Në futjen e këtyne elementeve ka ndikue edhe terreni i përdorimit të dogançes, krahinat veriore, me që greqishtja atje ishte një gjuhë e largët dhe e panjoftun. Ky terren mendojmë të ketë ndikue edhe për depërtimin e elementeve sllave. Puna në krahinat e Veriut — në Kosovë etj. i ka vu në kontakt zejtarët tanë shtetitë edhe me sllavishten, gjuhë prej nga janë marrë elemente si: *bogdanis, gospo, jaicë, kokoros, majkushe, mleko, pllata, sello*.

Dervishët malshovitë, me karakterin fetar të profesionit të tyre, kanë bamë që të futen në dogançe edhe elemente nga gjuha turke si p.sh. *gozho, guadh, — çuvall, jazëldi — jallezdi*.

Në dogançe gjejmë edhe fjalë nga aromunishtja: *fillush, fok, lapanzhare, pano*, si dhe ndonji tjetër nga gjuha e arxhive: *nashell, pure — puraq, spenell*.

R é s u m é

L'ARGOT DES ARTISANS AMBULANTS DE PERMET ET DE LESKOVIK

((Observations ethnographiques et linguistiques))

Dans cet article sont brossées les grandes lignes de l'argot le plus commun en Albanie: la dogançe. Le foyer de la naissance et de l'évolution de ce langage social, connu aussi sous les noms de malëshovitçe et lovidharçe, est Malëshove, une région de montagne s'étendant au S.—W. de Permet (dans l'Albanie du Sud). Ce langage est employé notamment par les étameurs ambulants. De là, la dogançe s'est ramifiée avec des variantes aussi chez d'autres artisans ambulants: les chirurgiens empiriques de Bual, les scieurs de long de Rrëzë de Permet, les savetiers de Poda de Leskovik, les maçons de Shalës, les sculpteurs de plafonds et de placards et les chaudronniers de Vërtop à Berat. Certains éléments détachés de cet argot sont arrivés jusqu'aux groupes sociaux de l'Albanie centrale. La richesse du lexique, la stabilité du sens des mots, la facilité des combinaisons morphologiques et syntaxiques, ont permis à cet argot d'exprimer non seulement des idées relevant des besoins du métier, mais également des phrases compliquées, en le rendant un de nos langages sociaux les plus élaborés et les plus étendus aussi bien comme extension géographique que comme nombre d'artisans qui l'emploient.

De cet argot l'auteur a enregistré, outre des éléments du lexique, aussi des entretiens, des événements et des contes humoristiques de caractère narratif. Il traite de l'étymologie de chaque terme en usage. Les recherches se sont étendues à 12 centres du pays. Pour ce qui est de l'ancienneté de la dogançe, comme terminus ad quem Haxhihasani considère l'époque du déplacement de quel-

ques familles de la région de Malëshove (Permet) et leur installation dans l'arrondissement de Berat (1769). Ces dernières, en même temps que le métier de chaudronniers, ont porté de leur pays d'origine aussi leur argot, la doganq qui n'est connue dans aucun autre village de l'arrondissement où ils se trouvent à l'heure actuelle. Un trait caractéristique de la doganq a été son usage par des groupes d'artisans ambulants. A ce point de vue ce langage peut être rangé parmi les argots des métiers. Mais la doganq a été employée aussi par une catégorie de gens qui vivaient de collectes soi-disant pour les besoins des institutions confessionnelles (constructions de téqués, églises, etc.). Bien que camouflées de cette façon, leurs collectes, qui finissaient dans leurs poches, n'étaient autre qu'une aumône, et à cet égard la doganq représentait encore un autre trait caractéristique: celui de l'argot des mendiants, des maquignons, commun à plusieurs argots de l'Europe. Il est à noter que l'emploi de la doganq par cette catégorie de gens est un cas unique il n'est pas rencontré dans nul autre argot de notre pays.

Nos artisans ambulants ont employé cet argot à l'intérieur du pays dans les zones où ils travaillaient en immigrants saisonniers et dans plusieurs villages de la Grèce habités par des Albanais (dans la région de Thèbes).

Pour l'étude de la dynamique de ce parler, du développement des domaines du lexique, de la structure et de son usage pratique, l'auteur analyse en détail l'organisation des métiers, les besoins et les intérêts professionnels, l'organisation et le mode d'existence des groupes qui font usage de cet argot. Au commencement, il brosse quelques considérations générales de nature géographique, économique et sociale de l'arrondissement de Permet, puis il présente chaque métier en particulier. Ainsi p. ex. sont donnés des renseignements sur le temps et les circonstances dans lesquelles s'est développé le métier de chaudronniers à Malëshove, les zones où ces artisans ambulants exerçaient leur métier, le temps qu'ils s'éloignaient de leur pays d'origine, le mode d'organisation des groupes, la distribution du travail à l'intérieur de ce dernier, les genres de travail faits, le mode de paiements pour le logement, la nourriture d'eux-mêmes et de quelque animal qu'ils se portaient avec, les circonstances dans lesquelles ils étaient obligés à faire usage du doganq, les termes créés concernant les procédés de leur travail, les besoins de vie journalière, les circonstances difficiles, etc.

Des renseignements sont donnés aussi sur les religieux de la Malëshove, les chirurgiens empiriques de Bual, les scieurs de long et les charbonniers de Permet. Dans l'argot de ces derniers l'auteur voit une variante importante de la doganq en élaboration profonde, au point de la rendre quasiment une branche indépendante. En raison de la position géographique, la lovidharqe offre aussi des points de contact avec un autre langage social plus au nord du pays: la purishte.

Dans la deuxième partie de ce travail est analysé le matériel lexical. Dans les 12 centres où ont été effectuées des recherches en vue de glaner des éléments du lexique, des entretiens et d'autres textes de cet argot, ont été enregistrés environ 1 500 mots, qui, après avoir été groupés, ont donné 667 éléments divers. Le lexique, avec ses explications en albanais, avec contexte et quelques considérations de nature générale étymologique, en même temps que les entretiens et les textes en doganq seront donnés dans le numéro prochain de ce bulletin.

Le fonds du lexique de la doganq est formé par les termes qui se rattachent aux métiers des usagers de cet argot, les dénominations des moyens de travail, les matières rentrant dans les procédés des objets traités. Ainsi, p. ex. les étameurs ont élaboré la terminologie des récipients de cuisine et des procédés de leur réparation; les chirurgiens ont créé la terminologie des maaldies

des herbes et des traitements populaires; les scieurs de long celle des moyens de travail, des outils dont ils ont besoin pour la préparation du bois d'oeuvre; les derviches malëshovites, la terminologie religieuse: prières, indulgences, oraisons, etc., par lesquelles ils obtiennent les aumônes des croyants.

Une place importante dans le fonds du lexique de la dogance va au milieu avec lequel ont été en contacts directs les artisans ambulants: les propriétaires et leur cercle familial, les gens qui avaient affaire aux travaux, leurs intérêts professionnels, les gouverneurs, les malfaiteurs, etc.

D'autres sphères qui ont élargi le fonds du lexique de la dogance sont le corps humain et ses membres, les besoins matériels (de l'alimentation, de l'habillement, etc.), le lieu de séjour, le milieu de famille, les rapports de vie conjugale, de parentage, de voisinage, etc.

Dans le fonds de la dogance on trouve des mots sur les phénomènes atmosphériques, du milieu géographique, de la flore, de la faune, etc.

Comme il arrive pour la langue commune, aussi dans l'usage de la dogance, certains éléments lexicaux appartiennent au fonds actif, en usage continuuel dans les rapports de la vie quotidienne du métier. Les terminologies des métiers particuliers ne vivent que chez leurs usagers. Quelques éléments appartiennent au fonds passif et ne sont connus que par un nombre limité d'hommes. Tous ceux-ci, l'auteur les a illustrés avec des exemples.

Des matériaux réunis, on constate que le nombre des concepts correspondant au vocabulaire de la dogance atteint le nombre de 1000.

Quelques uns des termes du fonds fondamental de cet argot ont souvent plus d'une acception. L'élargissement de l'acception est fait, dans quelques cas, sur la même base sémantique et sur le même schéma employé dans l'acquisition du premier sens. Ainsi, p. ex., le mot duno est employé dans le sens de s'eau et de la pluie, babje dans celui de cabas et de sac; çotak dans celui de coq et de louis d'or (de la figure du coq qu'avait la monnaie); fytylo pour beurre et huile; halès pour poisson et blé; rrotès pour moulin et auto, et ainsi de suite.

Un autre phénomène caractérisant la dogance, à côté de la polysémie, est la polymorphie, les différentes formes qu'ont pris ses éléments lexicaux. La pluralité des formes ainsi que la création de quelques mots différents pour le même concept, a son origine dans le caractère circonspect de la connaissance et de l'usage des langages sociaux. Ces langages vivent d'une façon intime chez des groupes limités d'hommes, qui ne sont que rarement en contact l'un avec l'autre, soit en raison de la distance de lieu, que de la différence de leurs intérêts de profession. Les chaudronniers de Brezhdan, les scieurs de long de Kaludh et les savetiers de Poda ne se réunissent qu'au hasard à faire usage de la dogance, et cela à cause de leur métier divers ces troupes d'artisans ambulants exercent leur métier dans des zones diverses. Aussi entre les artisans d'un même métier ne sont pas toujours les circonstances d'une coexistence continue. Les étameurs, aussi bien que les scieurs de long, les chirurgiens empiriques, etc. vont dans diverses régions en groupes de deux ou plusieurs personnes: c'est donc qu'ils travaillent longtemps loin les uns des autres. Il est tout naturel que dans de telles conditions d'isolement voient le jour fort souvent des formes, des acceptions et des mots à contenu et évolution indépendante.

Aux changements de forme se rattachent également plusieurs phénomènes phonétiques, une conséquence celle-ci de la dynamique de tels phénomènes agissant sur la langue maternelle. Dans la dogance on observe des assimilations et dissimilations de voyelles et de consonnes, des métathèses, etc.

Pour ce qui est de la structure du lexique de la dogance, on constate que la plus grande partie est formée par les noms; dans une mesure plus limitée

ce sont les adjectifs et les verbes, en très petits nombre sont les numéraux et les adverbes; pour ce qui est des conjonctions, des articles, des prépositions et des interjections on ne constate pas une création particulière, mais l'on fait recours à l'usage de ceux de la langue commune. De la même façon sont utilisés par ce langage aussi toutes les règles morphologiques et syntaxiques, les normes, les schémas et les formes agissant dans la construction du genre, du nombre, des cas de noms et d'ajectifs, de la flexion radicale des verbes, de la formation des mots, de leurs liens syntaxiques, etc.

La phrase, dans le langage social, n'a pas les nuances fines stylistiques, elle n'est pas caractérisée d'une variété de couleurs et de formes indirectes, et, ce partant, les temps verbaux utilisés dans ce cas sont ceux fondamentaux: présent, aoriste, imparfait, futur de l'indicatif; présent et imparfait du conjonctif; infinitif. Les modes conditionnelle optatif prescriptif ne sont employés que rarement, tandis que l'optatif de souhait n'est point employé.

A remarquer est le cours suivi dans le domaine de la sémantique en vue d'appliquer aux mots des nouveaux sens. Les langages sociaux empruntent à la langue maternelle le fonds principal à la création de leur lexique. Il y a des éléments lexicaux de la langue maternelle qui ont pénétré dans le lexique de la dogançe sans nul changement de forme ou de sens. C'est le cas des termes rares des parlars régionaux, des archaïsmes ou des emprunts des parlars du Nord du pays. D'usage assez courant sont les formes abrégées des mots, notamment de ceux de géographie (villes, villages, fleuves); les éléments de la technique, de la vie politique, etc.

Il y a d'autres mots de la langue maternelle qui ne gardent que la forme, pas le sens. On leur a attribué des nouveaux sens voisins à leur acception première. D'autres mots sont formés par harmonie imitative (onomatopées)..

La formation du sens des mots s'appuie essentiellement sur les traits communs du concept de base avec le nouveau concept formé. Ces processus métaphoriques s'appuient sur un trait caractéristique des sensations visuelles, auditives gustatives. Plus communes sont les créations sémantiques sur la base de la similitude de la forme, de la matière, de l'action. Dans des cas nombreux le nouveau sens se base sur la synecdoque, la similitude d'origine de l'objet, celle de l'âge ou du temps qui appartiennent au concept. Dans quelques cas, la nouvelle acception est donnée par le résultat au lieu de l'action, ou bien vice-versa par l'action au lieu de l'objet. Dans d'autres cas on utilise des traits physiques particuliers d'un homme donné, des croyances populaires, des légendes sur des lieux géographiques, etc.

Pour l'élargissement du fonds lexical de la dogançe on a tiré profit également, dans une certaine mesure, aussi des langues étrangères. Un plus grand nombre d'éléments ont été empruntés au grec. La position géographique de dogançe, sa diffusion dans des zones marginales, telles Permet et Leskovik, l'influence culturelle et religieuse sur ses porteurs, qui appartiennent dans leur majorité à la foi chrétienne, ont provoqué divers emprunts du grec. Dans la pénétration de ces éléments a influé également aussi le lieu d'usage de la dogançe: le Nord du pays, où le grec était une langue inconnue. Ce milieu septentrional, à l'avis de l'auteur, doit avoir influé également dans la pénétration des éléments slaves. Le travail dans les régions septentrionales, à Kosove et ailleurs, les a mis en contact également avec le slave, dont ils ont emprunté un certain nombre de mots.

Les derviches malëshovites, avec le caractère religieux de leur profession, ont provoqué l'emprunt à la dogançe aussi d'un certain nombre de mots turcs.

Les emprunts de l'aroumain sont plus limités. En plus petit nombre encore sont ceux du langage des tziganes.

